



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1291/18 prot.

Datë 27.10.2022

V E N D I M
Nr. 1053/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.10.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekti:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-25594-04-19-2022, me objekt: Loti 1 “*Karta, reagentë dhe aksesorë të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë ne QKTGJ dhe Bankat e gjakut në Tirane perfshire venien e pajisjeve ne perdorim*”, me fond limit 59.233.237 lekë pa Tvsh, zhvilluar me datë 20.05.2022 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Lasermed” SHPK
Rruga “Elbasanit”, Mjull – Bathore Nr. 4 (përballë TEG),
Farkë, Tiranë

- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut Tiranë
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Pegasus” SHPK
Rruga “Siri Kodra, tek ish Frigoriferi, Nr. 149, Tiranë
- Operatori ekonomik “Swissmed” SHPK
Rruga “Don Bosko”, Pallati “Nord Construction”, Kati 2,
Shk.3, Ap.3, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20-04-2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-25594-04-19-2022, me objekt: Loti 1 “Karta, reagentë dhe aksesori të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë ne QKTGJ dhe Bankat e gjakut në Tirane perfshire venien e pajisjeve ne perdorim”, me fond limit 59.233.237 lekë pa Tvsh, zhvilluar me datë 20.05.2022 nga autoriteti kontraktor.

II.2. Në datën 20.05.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3 Në datën 01.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Pegasus” SHPK	30.936.080	lekë	kualifikuar
2. “Swissmed” SHPK	44.500.000	lekë	kualifikuar
3. “Lasermed” SHPK	59.219.000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 07.06.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim - Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 16.06.2022, operatori ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK, ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Pegasus” SHPK dhe “Swissmed” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1291/2 prot., datë 17.06.2022 janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK në lidhje me pretendimet për mospërmbushje të kriterëve nga ana e operatorëve ekonomikë “Pegasus” SHPK dhe “Swissmed” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 167/20 prot, datë 28.06.2022 protokolluar me tonën me nr. 1291/5 prot datë 30.06.2022, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Lasermed” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin refuzimin e ankesës.

II.8. Me shkresën nr. 167/23 prot, datë 01.07.2022 protokolluar me tonën me nr. 1291/6 prot datë 04.07.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, informacion dhe dokumentacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Me shkresën nr. 1291/7 prot, datë 05.08.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion”, Komisioni Prokurimit Publik ju drejtua operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK, duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon:

Komisioni i Prokurimit Publik është duke shqyrtuar ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Laser Med” SHPK për skualifikimin e ofertës tuaj ekonomike, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-25594-04-19-2022, me objekt: Loti 1 “Karta, reagentë dhe aksesore të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë në QKTGJ dhe Bankat e gjakut në Tiranë përfshirë venien e pajisjeve në përdorim”, me fond limit 59.233.237 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 20.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut Tiranë.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, KPP shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike (për të cilat operatori ekonomik ankimes pretendon se nuk përmbushen nga ana juaj), për disa nga artikujt, tek katalogët dhe dokumentacioni i paraqitur nga ana juaj në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

Konkretisht, Komisioni shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike për artikujt sipas Shtojcës 5, të dokumentave të tenderit, për specifikimet teknike si më poshtë:

1. Artikulli – “Karta plastike për pacient”

- Kartat duhet të përmbajne anti-A, anti-B dhe anti-D me baze monoklonale.
- Kartat duhet të përmbajne edhe 2-mikrotubula neutral për qelizat A1 e B për metoden indirekte.
- Të ketë gjithashtu edhe një mikrotubul për kontrollin negativ (Ctl).

2. Artikulli - “Karta plastike për për dhurues”.

- Kartat duhet të përmbajne anti-A, anti-B, anti-DVI+ dhe anti-DVI- me baze monoklonale
- Kartat duhet të përmbajne edhe 2-mikrotubula neutral për qelizat A1 e B për metoden indirekte.

3. Artikulli – “Karta plastike për neonat”

- Kartat duhet të përmbajne anti-A, anti-B, anti-AB dhe anti-DVI+ me baze monoklonale.
- Kartat duhet të përmbajne edhe një mikrotubul me AHG për DCT.

4. Artikulli – “Karta Coombs” (AHG IgG + C3d)”

- Karta plastike me AHG-polispecifike (LISS/COOMBS).
- Kartat duhet të jene të pershtatshme për t’u përdorur për:
Kontroll për antitrupa
Identifikim i antitrupave
Pajtueshmeri
Test Coombs Direkt.

- Kartat duhet të kenë mikrotubula në të cilin të jete shtuar AHG-polispecifike (me anti-IgG origjine animale dhe anti-C3d monoklonale).

5. Artikulli – “Karta për Rh fenotip + Kell”

- Kartat duhet të përmbajne antitrupa monoklonale (me reagent-sera të inkorporuar në mikrotubulat e kartes ose reagenti të shtohet në të automatikisht në momentin e testimit): anti-C, anti-c, anti-E, anti-e dhe anti-K
- Kartat për përdorim të pacienti duhet të kenë gjithashtu edhe një mikrotubul ctl

6. Artikulli – “Karta për fenotip të zgjeruar (anti-k, anti-Fya, anti-Fyb, anti-Jka, anti-Jkb)”

1. Kartat duhet të kenë të suspenduar anti-trupat korespondues ose reagent-sera të shtohet në të automatikisht në momentin e testimit) si më poshtë:

- anti-k (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-M (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-N (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-S (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-s (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Le^a (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Le^b (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Jk^a (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Jk^b (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Lu^a (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Lu^b (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Fy^a (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Fy^b (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Kp^a (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Kp^b (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-P₁ (nese i disponueshem preferohen monoklonal)

7. Artikulli – “Karta + reagent-sera, për DCT-screen (te pakten IgG dhe C3d)”

- Në mikrotubulat e kartes duhet të ketë prezencë të të pakten 2-reagent serave të ndryshem AHG-monospecifike: anti-IgG dhe anti-C3d (monoklonale)
- Të ketë dhe një mikrotubul për kontrollin negativ.

Referuar sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur dhe shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, kërkohet nga ana juaj të dorëzoni pranë KPP-së informacionin dhe faktet se në cilin katalog apo dokument (faqe, paragraf etj.), nga ato të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden artikujt me specifikimet teknike të lartpërmendur.

Përsa më sipër kërkohet nga ana juaj të dorëzoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin e kërkuar, brenda ditës së nesërme të punës, nga marrja e kësaj shkresë.

II.10. Me shkresën nr. 29 prot., datë 16.08.2022, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1291/8 prot, datë 18.08.2022 me objekt: “Kthim përgjigje tuajës me prot 1291/7, datë 05.08.2022”

operatori ekonomik "Swissmed" SHPK ka dërguar informacion pranë Komisionit Prokurimit Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 1291/7 prot, datë 05.08.2022.

II.11. Me shkresën nr. 1291/12 prot, datë 11.10.2022, me objekt: "Kërkesë për informacion", Komisioni Prokurimit Publik ju drejtua operatorit ekonomik "Pegasus" SHPK, duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon:

"[...]"

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, KPP shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike (për të cilat operatori ekonomik ankimes pretendon se nuk përmbushen nga ana juaj), për disa nga artikujt, tek katalogët dhe dokumentacioni i paraqitur nga ana juaj në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

Konkretisht, Komisioni shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike për artikujt sipas Shtojcës 5, të dokumentave të tenderit, për specifikimet teknike si më poshtë:

Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe RhD (në një kartë të vetme – për pacient).

1. Kartat duhet të përmbajne **anti-A, anti-B dhe anti-D** me baze monoklonale.
2. Kartat duhet të përmbajne edhe 2-mikrotubula neutral për qelizat **A₁** e **B** për metoden indirekte.
3. Të ketë gjithashtu edhe një mikrotubul për kontrollin negativ (Ctl).
4. Pamja e jashtme e kartave duhet të jete me kolona transparente, pa plasaritje/tharje pa buleza ajri apo solucioni të shperndara neper tubula dhe të mos kete carje apo demtime të tjera të fletes vulosese të sigurise.
5. Reagentet qelizor A1 dhe B të jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
6. Pamja e jashtme: reagentet duhet të jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
7. Sasia e kerkuar bashkangjitur

Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe përcaktimin e dyfishtë të RhD (në një kartë të vetme – për dhurues).

1. Kartat duhet të përmbajne **anti-A, anti-B, anti-DVI+** dhe **anti-DVI-** me baze monoklonale
2. Kartat duhet të përmbajne edhe 2-mikrotubula neutral për qelizat **A₁** e **B** për metoden indirekte.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet të jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni të shperndara neper tubula dhe të mos kete carje ose demtime të tjera të fletes vulosese të sigurise.
4. Reagentet qelizor A1 dhe B të jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
5. Pamja e jashtme: reagentet duhet të jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
6. Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO dhe DCT – neonat

1. Kartat duhet të përmbajne **anti-A, anti-B, anti-AB** dhe **anti-DVI+** me baze monoklonale.
2. Kartat duhet të përmbajne edhe nje mikrotubul me AHG për DCT.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet të jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni të shperndara neper tubula dhe të mos kete carje ose demtime të tjera të fletes vulosese të sigurise.
4. Pamja e jashtme: reagentet duhet të jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
5. Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike për fenotipin e Rh + Kell

1. Kartat duhet të përmbajne antitrupa monoklonale (me reagent-sera të inkorporuar në mikrotubulat e kartes ose reagenti të shtohet në të automatikisht në momentin e testimit): **anti-C, anti-c, anti-E, anti-e dhe anti-K**
2. Kartat për përdorim të pacientit duhet të kenë gjithashtu edhe një mikrotubul kontrol.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet të jetë me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucion të shpërndara nëpër tubula dhe të mos ketë çarje ose demtime të tjera të fletës vulozëse të sigurisë.
4. Sasia e kërkuar është bashkëgjatë.

Karta plastike për përcaktimin e fenotipit të zgjeruar

1- Kartat duhet të kenë të suspenduar anti-trupat korrespondues ose reagent-sera të shtohet në të automatikisht në momentin e testimit) si më poshtë:

- **anti-k** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-M** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-N** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-S** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-s** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Le^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Le^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Jk^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Jk^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Lu^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Lu^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti- Fy^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti- Fy^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Kp^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Kp^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-P₁** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)

2- Pamja e jashtme e kartave plastike duhet të jetë transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucion të shpërndara nëpër tubula dhe të mos ketë çarje ose demtime të tjera të fletës vulozëse të sigurisë.

3- Sasia e kërkuar është bashkëgjatë.

Karta plastike për identifikimin e llojit të antitropave në DCT-pozitiv.

1 - Në mikrotubulat e kartes duhet të ketë prezencë të të paktën 4-reagent serave të ndryshëm AHG-monospecifike: **anti-IgG** dhe **anti-C3d** (monoklonale)

2 - Të ketë dhe një mikrotubul për kontrollin negativ.

5. Pamja e jashtme e kartave plastike duhet të jetë me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucion të shpërndara nëpër tubula dhe të mos ketë çarje ose demtime të tjera të fletës vulozëse të sigurisë.

4 - Sasia e kërkuar është bashkëgjatë.

Referuar sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur dhe shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, kërkojmë nga ana juaj të dorëzoni pranë KPP-së informacionin dhe faktet se në cilin katalog apo dokument (faqe, paragraf etj.), nga ato të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden specifikimet teknike për secilin nga artikujt e lartpërmendur. Përsa më sipër kërkojmë nga ana juaj të dorëzoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin e kërkuar, brenda ditës së nesërme të punës, nga marrja dijani e kësaj shkresë.”

II.12. Me anë të shkresës, të protokolluar pranë KPP-së nr. 1291/13 prot, datë 13.10.2022, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK ka dërguar informacion pranë Komisionit Prokurimit Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 1291/12 prot, datë 11.10.2022.

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se shkresën nr. 1291/3 prot, datë 23.06.2022 të operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK dhe me shkresën nr. 1291/4 prot, datë 23.06.2022 të operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK janë paraqitur argumenta nga subjektet e interesuara “Swissmed” SHPK dhe “Pegasus” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr.162/2020 Për Prokurimin Publik.

II.14. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK në mbështetje të nenit 115 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me shkresën nr.1291/14 prot. datë 21.10.2022 me lëndë “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, KPP ka njoftuar autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik “Pegasus” SHPK për zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 24.10.2022, ora 12:00 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, ftoi në seancë dëgjimore, autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik “Pegasus” SHPK, ndërkohë, nga ana e autoritetit kontraktor u kërkua përfaqësimi në dy nivele, specialistë të fushës, anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, si dhe pjesëmarrjen e një specialisti/ eksperti sipas fushës së ekspertizës përkatëse, i cili nuk është përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit.

II.15. Në datën 24.10.2022, ora 12:00 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca Dëgjimore midis operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, përfaqësuesve të autoritetit kontraktor (një specialist i fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave Prof.aAsoc. znj. I.S, si dhe pjesëmarrjen e një specialisti/ eksperti sipas fushës së ekspertizës përkatëse, i cili nuk ishte përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit Dr. R.Gj) dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik. Në seancën dëgjimore, Komisioni drejtoi pyetje specialistëve të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesve të operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, me qëllim shqyrtimin e pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues dhe verifikimin e specifikimive teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor. Gjatë seancës, u mbajt Procesverbali datë 24.10.2022, i cili u nënshkrua nga të gjitha palët pjesëmarrëse në seancë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Lasersed” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK SHPK me argumentin se: “2- Nuk ploteson kriterin kualifikues të dhene në pikën 2.3.5 të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, pasi kataloget e Ortho Diagnostics nuk plotesojnë specifikimet teknike të artikujve si më poshtë:

a) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.1 “Karta plastike për Pacient” të ofertuar nga ky OE nuk vërtetohet se përmbajne anti-A, anti-B dhe anti-D me baze monoklonale dhe 2-mikrotubula neutral për qelizat A1 e B për metodën indirekte, si dhe një mikrotubul për kontrollin negativ (Ctl) sikurse është përcaktuar në Shtojcën 5 të DT ku është përcaktuar se: “Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe RhD (në një kartë të vetme – për pacient).

1. Kartat duhet të përmbajne anti-A, anti-B dhe anti-D me baze monoklonale.
2. Kartat duhet të përmbajne edhe 2-mikrotubula neutral për qelizat A1 e B për metodën indirekte.
3. Të ketë gjithashtu edhe një mikrotubul për kontrollin negativ (Ctl).
4. Pamja e jashtme e kartave duhet të jete me kolona transparente, pa plasaritje/tharje pa buleza ajri apo solucioni të shpërndara neper tubula dhe të mos ketë carje apo demtime të tjera të fletës vulozuese të sigurisë.
5. Reagentet qelizor A1 dhe B të jenë suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10 ml.
6. Pamja e jashtme: reagentet duhet të jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
7. Sasia e kerkuar bashkëngjitur.”.

b) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.2 “Karta plastike për Dhurues” të ofertuar nga ky OE nuk vërtetohet se përmbajne anti-B, anti-DVI+ dhe 2-mikrotubula neutral për qelizat A1 e B për metodën indirekte, sikurse është përcaktuar në Shtojcën 5 të DT ku është përcaktuar se: “Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe përcaktimin e dyfishtë të RhD (në një kartë të vetme – për dhurues).

1. Kartat duhet të përmbajne anti-A, anti-B, anti-DVI+ dhe anti-DVI- me baze monoklonale
2. Kartat duhet të përmbajne edhe 2-mikrotubula neutral për qelizat A1 e B për metodën indirekte.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet të jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni të shpërndara neper tubula dhe të mos ketë carje ose demtime të tjera të fletës vulozuese të sigurisë.
4. Reagentet qelizor A1 dhe B të jenë suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
5. Pamja e jashtme: reagentet duhet të jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
6. Sasia e kerkuar bashkëngjitur”.

c) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.3 “Karta plastike për neonat” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetohet se permbajne anti-B, anti-DVI+ dhe nje mikrotubul me AHG per DCT, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT ku eshte percaktuar se: “Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO dhe DCT – neonat.

1. Kartat duhet te permbajne anti-A, anti-B, anti-AB dhe anti-DVI+ me baze monoklonale.
2. Kartat duhet te permbajne edhe nje mikrotubul me AHG per DCT.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
4. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
5. Sasia e kerkuar bashkangjitur.”

ç) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.4 “Karta Coombs (AHG IgG+C3d)” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetohet se permbajne AHG-polisferike (me anti-IgG origjine animale dhe anti-C3d monoklonale, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT ku eshte percaktuar se: “Karta plastike me AHG-polispecifike (LISS/COOMBS).

1- Kartat duhet të jene të pershtatshme për t’u përdorur për:

- Kontroll per antitropa
- Identifikim i antitropave
- Pajtueshmeri
- Test Coombs Direkt.

2- Kartat duhet të kene mikrotubula ne te cilin te jete shtuar AHG-polispecifike (me anti- IgG origjine animale dhe anti-C3d monoklonale).

3- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.

4- Sasia e kerkuar bashkangjitur”

d) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.6 “Karta per Rh fenotip + Kell” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetohet se permbajne anti-e dhe anti-K dhe nje mikrotub me AHG per DCT, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT ku eshte percaktuar se: “Karta plastike për fenotipin e Rh + Kell

1. Kartat duhet te permbajne antitropa monoklonale (me reagent-sera te inkorporuar ne mikrotubulat e kartes ose reagenti te shtohet ne to automatikisht ne momentin e testimit): anti-C, anti-c, anti-E, anti-e dhe anti-K
2. Kartat per perdorim pacienti duhet te kenë gjithashtu edhe një mikrotubul ctl.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
4. Sasia e kerkuar bashkangjitur.”

dh) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.8 “Karta për fenotip të zgjeruar (anti-k, anti-Fya, anti-Fyb, anti-Jka, anti-Jkb)” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetohet se permbajne anti-k,

anti-M, anti-N, anti-S, anti-s, anti-Lea, anti-Leb, anti-Jka, anti-Jkb, anti-Lua, anti-Lub, anti-Fya, anti-Fyb, anti-Kpa, anti-Kpb dhe anti-P1, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT ku eshte percaktuar se: “Karta plastike për përcaktimin e fenotipit të zgjeruar

1- Kartat duhet te kene te suspenduar anti-trupat korespondues ose reagent-sera te shtohet ne to automatikisht ne momentin e testimit) si me poshte:

- *anti-k (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-M (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-N (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-S (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-s (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Lea (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Leb (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Jka (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Jkb (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Lua (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Lub (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Fya (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Fyb (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Kpa (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-Kpb (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*
- *anti-P1 (nese i disponueshem preferohen monoklonal)*

2- Pamja e jashtme e kartave plastike duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.

3- Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

e) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.9 “Karta + reagent sera, për DCT-screen (te pakten IgG dhe C3d)” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-IgG dhe anti-C3d (monoklonale) dhe nje mikrotub per kontrollin negativ, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT ku eshte percaktuar se: “Karta plastike për identifikimin e llojit të antittrupave në DCT-pozitiv.

1. Në mikrotubulat e kartes duhet të kete prezence të të pakten 2-reagent serave të ndryshem AHG-monospecifike: anti-IgG dhe anti-C3d (monoklonale)

2. Të kete dhe nje mikrotubul per kontrollin negative.

3. Pamja e jashtme e kartave plastike duhet te jete me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.

4. Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 për Lotin 1 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuara).

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimet teknike” të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektornike përcaktohet si më poshtë:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Reagentë dhe aksesorë të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë pajisjet në përdorim

<i>Nr</i>	<i>EMERTIMI</i>	<i>NJESIA</i>	<i>SASIA</i>
1	<i>Karta plastike për Pacient</i>	<i>Karta</i>	<i>25 000</i>
2	<i>Karta plastike për Dhurues</i>	<i>Karta</i>	<i>25 000</i>
3	<i>Karta plastike për neonat</i>	<i>Karta</i>	<i>3 000</i>
4	<i>Karta Coombs (AHG IgG+C3d)</i>	<i>Testime</i>	<i>12 500</i>
5	<i>Karta neutrale</i>	<i>Testime</i>	<i>1 200</i>
6	<i>Karta për Rh fenotip + Kell</i>	<i>Testime</i>	<i>15 200</i>
7	<i>Karta për Dëeak (Coombs anti-IgG)</i>	<i>Testime</i>	<i>2 000</i>
8	<i>Karta për fenotip të zgjeruar (anti-k, anti-Fya, anti-Fyb, anti-Jka, anti-Jkb)</i>	<i>Testime</i>	<i>100</i>
9	<i>Karta + reagent-sera, për DCT-screen (te pakten IgG, IgM, IgA, C3d)</i>	<i>Testime</i>	<i>60</i>
10	<i>Pool qelizor (me 2-qeliza, AHG)</i>	<i>Testime</i>	<i>10 000</i>

11	Panel qelizor I-II-III (AHG)	Panel 3x10ml	10
12	Panel 11-qelizor (AHG)	Panel 11x4ml	10
13	Sete për Kontrollin e Cilësisë	set	10
14	Anti-A1	teste	30
15	Anti-H	teste	50
16	Anti – M	teste	50
17	Anti - N	teste	30
18	Anti - S	teste	30
19	Anti – s	teste	30
20	Anti Le ^a	teste	30
21	Anti Le ^b	teste	30
22	Anti Jk ^a	teste	30
23	Anti Jk ^b	teste	30
24	Anti Lu ^a	teste	20
25	Anti Lu ^b	teste	20
26	Anti Fy ^a	teste	30
27	Anti Fy ^b	teste	30
28	Anti Kp ^a	teste	10
29	Anti Kp ^b	teste	10
30	Anti P1	teste	10

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE KARTAVE PLASTIKE, REAGENTEVE DHE AKSESOREVE TE TJERE TE NEVOJSHEM PER TESTIMET IMUNOHEMATOLOGJIKE.

Reagente dhe aksesore te tjere te nevojshem per testimet ne Laboratorin e Imuno Hematologjise (QKTGJ) dhe bankat e gjakut ne Tirane, se bashku me pajisjet ne perdorim.

Të përgjithshme

1- Te gjithë reagentet me origjine humane duhet te jene prej materiali baze (gjak dhe produktete tij) te testuar, qe rezulton negativ per anti-HIV, anti-HCV dhe HBsAg.

- 2- Per te gjithë reagentet qe ofrohen duhet te paraqiten specifikimet teknike te tyre (kataloge, flete shoqeruese e kartave dhe reagenteve).
- 3- **Mosparaqitja e specifikimeve teknike në dokumentet e paraqitura nga OE është kusht skualifikues.**
- 4- Afati i skadences per **kartat plastike** te jete te pakten 8 muaj nga data e marrjes ne dorezim (levrimin te tyre).
- 5- Afati i skadences per te gjithë **Reagentet, sol. Holluese (Diluent)** dhe **sol. Shplares/Tretesit** te jete mbi 12 muaj nga koha e marrjes ne dorezim.
- 6- Afati i skadences per gjithë panelet dhe **Reagentet qelizor** te jete deri ne 4 jave nga koha e marrjes se tyre ne dorezim.
- 7- Levrimi i kartave plastike te behet sipas kerkeses se institucionit dhe afateve respektive te skadenceve. Levrimi i reagenteve/paneleve te tjere qelizor do te behet cdo muaj, sipas afateve perkatese te skadences apo kerkeses se institucionit.
- 8- Amballazhi shishe qelqi me tape me/pa pikatore.
- 9- Etiketa duhet te jete e qendrueshme ndaj lageshtise se frigoriferit. Shkrimi te jete I qendrueshem deri ne fund te skadences.

Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe RhD (në një kartë të vetme – për pacient).

5. Kartat duhet te permbajne **anti-A, anti-B** dhe **anti-D** me baze monoklonale.
6. Kartat duhet te permbajne edhe 2-mikrotubula neutral per qelizat **A₁** e **B** per metoden indirekte.
7. Të ketë gjithashtu edhe një mikrotubul per kontrollin negativ (Ctl).
8. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete me kolona transparente, pa plasaritje/tharje pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje apo demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
5. Reagentet qelizor **A₁** dhe **B** te jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
6. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
7. Sasia e kerkuar bashkangjitur

Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe përcaktimin e dyfishtë të RhD (në një kartë të vetme – për dhurues).

4. Kartat duhet te permbajne **anti-A, anti-B, anti-DVI+** dhe **anti-DVI-** me baze monoklonale
5. Kartat duhet te permbajne edhe 2-mikrotubula neutral per qelizat **A₁** e **B** per metoden indirekte.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
4. Reagentet qelizor **A₁** dhe **B** te jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
5. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
6. Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO dhe DCT – neonat

3. Kartat duhet te permbajne **anti-A, anti-B, anti-AB** dhe **anti-DVI+** me baze monoklonale.

4. Kartat duhet te permbajne edhe nje mikrotubul me AHG per DCT.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
4. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
5. Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike me AHG-polispecifike (LISS/COOMBS).

1- Kartat duhet të jene të pershtatshme për t'u përdorur për:

- Kontroll per antitrupa
- Identifikim i antitrupave
- Pajtueshmeri
- Test Coombs Direkt.

2- Kartat duhet të jene mikrotubula ne te cilin te jete shtuar AHG-polispecifike (me **anti- IgG** origjine animale dhe **anti-C3d** monoklonale).

3- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.

4- Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike me suspension neutral.

1- Kartat plastike, duhet te jene te pershtatshme per t'u perdorur per:

- Kontroll / Identifikim antitrupash (me metoden enzimatike)
- Pajtueshmeri
- Metoden indirekte te percaktimit te grupit.
- Percaktimin e titrit te imunizimit (sipas hollimeve perkatese).

2- Kartat duhet te jene kolona me suspension neutral, te afta per te kapur reaksionet nga antitrupat reaktive me tekniken enzimatike dhe ate me saline.

3- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.

4- Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike për fenotipin e Rh + Kell

6. Kartat duhet te permbajne antitrupa monoklonale (me reagent-sera te inkorporuar ne mikrotubulat e kartes ose reagenti te shtohet ne to automatikisht ne momentin e testimit): **anti-C, anti-c, anti-E, anti-e dhe anti-K**

7. Kartat per perdorim pacienti duhet te kenë gjithashtu edhe një mikrotubul ctl.

8. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.

9. Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike që përmbajnë AHG (anti-IgG) për përcaktimin e D^{ëak}

- 1- Kartat duhet te kene te shtuar antiglobuline humane, anti-IgG. Mund te perdoret edhe per qellime te tjera si: direkt/indirekt coombs test (kontroll / identifikim antittrupash e pajtueshmeri).
- 2- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
- 3- Reagenti per konfirmimin e $D^{ëeak}$ me ane te ICT, te permbaje anti-D, IgG-monoklonal
- 4- Pamja e jashtme: Reagenti duhet te jete pa turbullira apo precipitime.
- 5- Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

Karta plastike për përcaktimin e fenotipit të zgjeruar

1- Kartat duhet te kene te suspenduar anti-trupat korespondues ose reagent-sera te shtohet ne to automatikisht ne momentin e testimit) si me poshte:

- **anti-k** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-M** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-N** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-S** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-s** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Le^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Le^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Jk^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Jk^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Lu^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Lu^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti- Fy^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti- Fy^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Kp^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-Kp^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- **anti-P₁** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)

2- Pamja e jashtme e kartave plastike duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.

3- Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

Karta plastike për identifikimin e llojit të antittrupave në DCT-pozitiv.

1 - Në mikrotubulat e kartes duhet të kete prezence të të pakten 4-reagent serave të ndryshem AHG-monospecifike: **anti-IgG**, **anti-IgA**, **anti-IgM**, dhe **anti-C3d** (monoklonale)

2 - Të kete dhe nje mikrotubul per kontrollin negativ.

10. Pamja e jashtme e kartave plastike duhet te jete me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.

4 - Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

Panele qelizor për kontroll/identifikim të antittrupave të parregullt

Pool qeliza për kontroll të antittrupave të parregullt.

1. Pool-i qelizor per identifikimin e antittrupave te parregullt te pacientet duhet te jete me origjine humane.

2. Qelizat e perdorura ne kete pool duhet te jene nga dhurues unik/te vetem, grup O.
3. Të kenë një përqendrim 0.8% ($\pm 0.1\%$) e te jene te pershtatshme per t'u perdorur në kartat plastike respektive.
4. Pamja e jashtme duhet te jete e paster pa trubullime, pa hemolize apo koagula.
5. Sasia duhet te jete sipas kerkeses.

Panel 3-qelizor për kontroll/identifikim te antitropave te parregullt

1. Paneli 3-qelizor per identifikimin e antitropave te parregullt te pacientet duhet te jete me origjine humane.
2. Qelizat e perdorura ne kete panel duhet te jene nga dhurues unik/te vetem, grup O.
3. Te kene nje përqendrim 0.8% ($\pm 0.1\%$) e te jene te pershtatshme per t'u perdorur ne kartat respektive me xhel.
4. Pamja e jashtme duhet te jete e paster pa trubullime, pa hemolize apo koagula.
5. Sasia duhet te jete sipas kerkeses.

Panel II-qelizor për identifikimin e antitropave antieritrocitare.

Panele per identifikimin e antitropave anti-eritrocitare me sinjifikance klinike. Këto panele duhet të jene te tille qe te sigurojne nje shperndarje optimale te antigeneve per identifikimin e anti-trupave antieritrocitare.

Panelet te jene te pershtatshem per identifikimin e antitropave vetem me metoden AHG (anti-globuline humane). Kushtet të jenë si me poshte:

1. Të jene suspensione eritrocitare te pershtatshme per t'u perdorur me kartat plastike respektive.
2. Pamja e jashtme e tyre duhet te jete e paster pa trubullime, hemolize apo koagula.
3. Sasia duhet te jete nga 1 panel, me intervale mujore levrimi, sipas kerkeses.

Set për Kontrollin e Cilësisë (esencial/i perzgjedhshem)

1. Kërkohet të behet kontrolli i performances se instrumentave apo teknikave te perdorura per percaktimin e grupit te gjakut (direkt/indirekt), skrinimit per antitropa, me mostra gjaku me grup gjaku te njohur dhe antitropa te identifikuar paraprakisht. Këto kontrolle duhet të realizohen perpara fillimit te cdo dite pune.
2. Pamja e jashtme e tyre duhet te jete e paster pa trubullime, hemolize apo koagula.
3. Sasia duhet te jete nga 1 set me intervale te levrimit, sipas kerkeses.

SPECIFIKIMET TEKNIKE
per pajisjet qe do jene ne perdorim

Platforma në përdorim duhet të përbëhet nga dy pajisje (kryesore dhe back-up) të cilat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. Të jenë **tërësisht automatike** me centrifugë, inkubatorë, lexues dhe monitor të integruar në një njësi të vetme, se bashku me kompjuterat e nevojshem për rishikimin, validimin dhe transferimin e te dhenave.
- b. Të kenë kapacitet ngarkimi të mostrave jo më pak se 80 për pajisjen kryesore dhe jo më pak se 40 për pajisjen back-up.
- c. Të punojnë me **ngarkesë të vazhdueshme** dhe jo në batch.
- d. Të ofrojnë titrimin automatik për antitropa të parregullt në të paktën një prej pajisjeve në përdorim.
- e. Të ofrojë një kontroll cilësie esencial/të përzgjedhshëm
- f. Të ofrojnë STAT
- g. Të jenë të aftë të njohin diametra dhe madhësi të ndryshme tubash origjinale
- h. Të ofrojnë informacion në kohë reale mbi gjendjen e reagentëve dhe statusin e mostrave në testim e sipër duke përfshirë edhe sinjalet akustike.
- i. Të ofrojë pamje me resolution të lartë për një mënaxhim sa më të sigurtë të rezultateve.
- j. Të disponojnë sisteme efikase për evitimin e kontaminimit të kryqëzuar.
- k. Të sigurojë lidhjen LIS. Operatori Ekonomik merr përsipër shpenzimet e lidhjes së pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri në mbarimin e plote të artikujve të prokuruar.

Për një cilësi dhe siguri maksimale të këtyre rezultateve tepër sensitive DUHET që pajisjet në përdorim, kartat që do të përdoren në to dhe reagentët përkatës të jenë të së njëjtës kompani.

Pajisjet në përdorim për sistemin gjysmëautomatik duhet të jenë sa/si më poshtë:

- **Centrifugë (5cope)** e përshtatshme për centrifugimin e kartës për testim imunoematologjik. Me një kapacitet jo më pak se 10 karta.
- **Inkubator (5 cope)** për inkubimin e kartave që të ketë interval të modifikueshëm të kohës sipas nevojave të laboratorit për testimet imunoematologjike.
- **Reader automatik (5 cope)** i kartave. Kjo pajisje duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - Të ofrojë mundësinë e paraqitjes në një monitor të rezultatit, mundësinë për ndërhyrje të menjkut në interpretim dhe mundësinë e printimit të rezultatit.
 - Të ofrojë pamje me resolution të lartë për një menaxhim sa më të sigurtë të rezultateve.
 - Të lexojë bar-code të mostrave të gjakut që do të testohen dhe të kartave mbi të cilat do të punohet.
 - Të sigurojë lidhjen me LIS. Operatori Ekonomik merr përsipër shpenzimet e lidhjes së pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe të ofrojë mirembajtjen e pajisjeve deri në mbarimin e plote të artikujve të prokuruar

Për një cilësi dhe siguri maksimale të këtyre rezultateve tepër sensitive DUHET që pajisjet në përdorim, kartat që do të përdoren në to dhe reagentët përkatës të jenë të së njëjtës kompani.

III.1.3. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit, përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 5 SPECIFIKIMET TEKNIKE

**SPECIFIKIMET TEKNIKE TE KARTAVE PLASTIKE, REAGENTEVE DHE
AKSESOREVE TE TJERE TE NEVOJSHEM PER TESTIMET
IMUNOHEMATOLOGJIKE.**

Tek specififikimet teknike te pergjithshme, pika 4 dhe 5:

ISHTE...

4- Afati i skadences per kartat plastike te jete te pakten 8 muaj nga data e marrjes ne dorezim (levrimin te tyre)

5- Afati i skadences per te gjithë Reagentet, sol. Holluese (Diluent) dhe sol. Shplares / Tretesit te jete mbi 12 muaj nga koha e marrjes ne dorezim

BEHET

4- Afati i skadences per kartat plastike te jete te pakten 5 muaj nga data e marrjes ne dorezim (levrimin te tyre)

5- Afati i skadences per te gjithë Reagentet, sol. Holluese (Diluent) dhe sol. Shplares / Tretesit te jete mbi 8 muaj nga koha e marrjes ne dorezim

Tek specififikimet teknike te kartave plastike, pika 1:

ISHTE....

Karta plastike për identifikimin e llojit të antitropave në DCT-pozitiv.

1 - Në mikrotubulat e kartes duhet të ketë prezence të të pakten 4-reagent serave të ndryshem AHG-monospecifike: **anti-IgG, anti-IgA, anti-IgM, dhe anti-C3d** (monoklonale)

BEHET

Karta plastike për identifikimin e llojit të antitropave në DCT-pozitiv.

1- Në mikrotubulat e kartes duhet të ketë prezence të të pakten 2-reagent serave të ndryshem AHG-monospecifike: **anti-IgG dhe anti-C3d** (monoklonale)

Saktesimet e mesiperme jane pasqyruar edhe ne tabelen si meposhte tek pika nr.9.

ISHTE....

Reagentë dhe aksesorë të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, perfshire pajisjet ne perdorim

Nr	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
9	Karta + reagent-sera, për DCT-screen	Testime	60

	(te pakten IgG, IgM, IgA, C3d)		
--	--------------------------------	--	--

BEHET:

Reagentë dhe aksesori të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshire pajisjet ne perdorim

Nr	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
9	Karta + reagent-sera, për DCT-screen (te pakten IgG dhe C3d)	Testime	60

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Swissmed” SHPK në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojca 5 “Formulari i specifikimeve teknike”;
- Deklaratë nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK mbi të dhënat për kompaninë prodhuese, origjinën e mallit dhe direktivën e aplikueshme për artikujt e përcaktuar në DST.
- Katalog “Product & Instrumentation Catalogue 2020”, nga Ortho Clinical Diagnostics (i përkthyer dhe i noterizuar);
- Katalog “ORTHO VISION ® Max Sëift Analyzer Technical Specifications For Ortho Biovue ® System”, (i përkthyer dhe i noterizuar);
- Katalog Antitoxin GmbH (i përkthyer dhe i noterizuar);

III.1.5. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.6. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.8. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë

tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet

ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.1.10 . Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, ka përcaktuar specifikimet teknike të cilat duhet të përmbushin produktet objekt prokurimi. Gjithashtu, në “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 e “Kapacitetit teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentat duhet të jene të perkthyer dhe të noterizuara).

KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto artikuj.

III.1.9. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, Deklaratë mbi të dhënat për kompaninë prodhuese, origjinën e mallit dhe direktivën e aplikueshme për artikujt e përcaktuar në DST, si dhe katalogët e produkteve të ofertuar. Konkretisht Katalog

“Product & Instrumentation Catalogue 2020”, nga Ortho Clinical Diagnostics (i përkthyer dhe i noterizuar); Katalog “ORTHO VISION ® Max Sëift Analyzer Technical Specifications For Ortho Biovue ® System”, (i përkthyer dhe i noterizuar) dhe Katalog Antitoxin GmbH (i përkthyer dhe i noterizuar)si dhe katalogët e produkteve të ofruara, të përkthyer dhe të noterizuar.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke qenë se KPP shfaq vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike për të cilat operatori ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, për disa nga artikujt, tek katalogët dhe dokumentacioni i paraqitur nga ky i fundit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), KPP me anë të shkresë nr.1291/7 prot., datë 05.08.2022 i kërkoi operatorit ekonomik “SSwissmed” SHPK, me qëllim gjykimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, të dorëzohë pranë KPP-së informacionin dhe faktet se në cilin katalog apo dokument (faqe, paragraf etj.), nga ato të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden artikujt me specifikimet teknike të lartpërmendura nga operatori ekonomik ankimues.

Me anë të shkresën nr. 29 prot., datë 16.08.2022, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1291/8 prot, datë 18.08.2022 me objekt: “*Kthim përgjigje tuajës me prot 1291/7, datë 05.08.2022*” operatori ekonomik “Swissmed” SHPK ka dërguar informacion pranë Komisionit Prokurimit Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 1291/7 prot, datë 05.08.2022.

III.1.11. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, dokumentacioni i dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, si dhe sqarimet e vetë këtij të fundit dorëzuar pranë KPP-së, vërejmë se disa nga specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nuk gjenden të pasqyruara në katalogët e dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Konkretisht, për artikullin nr. 1 “Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe RhD (në një kartë të vetme – për pacient)”, në specifikimet teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar “*1. Kartat duhet te permbajne anti-A, anti-B dhe anti-D me baze monoklonale. 2. Kartat duhet te permbajne edhe 2-mikrotubula neutral per qelizat A1 e B per metodën indirekte; 3.Të ketë gjithashtu edhe një mikrotubul per kontrollin negativ (Ctl); 4.Pamja e jashtme e kartave duhet te jete me kolona transparente, pa plasaritje/tharje pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje apo demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise; 5. Reagentet qelizor A1 dhe B te jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml; 6. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime; 7. Sasia e kerkuar bashkangjitur*”, ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK si dhe informacioni i dorëzuar nga ky i fundit pranë KPP-së ku citon “*Artikulli Karta plastike për pacient – kodi 707155 gjendet në faqen 62 të katalogut (Ortho), Artikulli Kodi 707550 gjendet në faqen 62 të katalogut (Ortho); Kodi 6904623 gjendet në faqen 66 të katalogut (Ortho)*”, nga verifikimi, konstatohet se, në faqen 62 të katalogut “Ortho” në kodin 707155 përcaktohet “*ORTHO BioVue® ABO-Rh D Combo (A, B, D, Control, Reverse, Reverse)*”, në kodin 707150 përcaktohet “*ORTHO BioVue® ABO-Rh D Combo (A, B, AB, D, CDE,Control)*” dhe në faqen 66 të katalogut, në kodin 6904623 përcaktohet “*Anti – D (DVI)*”.

Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se “*Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.1 “Karta plastike për Pacient” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetohet se*

permbajne anti-A, anti-B dhe anti-D me baze monoklonale dhe 2-mikrotubula neutral per qelizat A1 e B per metoden indirekte, si dhe nje mikrotubul per kontrollin negativ (Ctl)”, nga verifikimi i katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK konstatohet se në këtë katalog nuk pasqyrohen të gjitha specififikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues.

Në lidhje me artikullin nr.2 “Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe përcaktimin e dyfishtë të RhD (në një kartë të vetme – për dhurues)” në specififikimet teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar “1. Kartat duhet te permbajne anti-A, anti-B, anti-DVI+ dhe anti-DVI- me baze monoklonale; 2. Kartat duhet te permbajne edhe 2-mikrotubula neutral per qelizat A₁ e B per metoden indirekte; 3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise; 4. Reagentet qelizor A1 dhe B te jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml; 5. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime; 6. Sasia e kerkuar bashkangjitur”, ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK si dhe informacioni i dorëzuar nga ky i fundit pranë KPP-së ku citon “Artikulli Karta plastike për dhurues – kodi 707155 gjendet në faqen 62 të katalogut (Ortho), Artikulli Kodi 707550 gjendet në faqen 62 të katalogut (Ortho); Kodi 6904623 gjendet në faqen 66 të katalogut (Ortho)”, nga verifikimi konstatohet se, në faqen 62 të katalogut “Ortho” në kodin 707155 përcaktohet “ORTHO BioVue® ABO-Rh D Combo (A, B, D, Control, Reverse, Reverse)”, në kodin 707150 përcaktohet “ORTHO BioVue® ABO-Rh D Combo (A, B, AB, D, CDE, Control)” dhe në faqen 66, në kodin 6904623 përcaktohet “Anti – D (DVI)”. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se “Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.2 “Karta plastike për Dhurues” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-B, anti-DVI+ dhe 2-mikrotubula neutral per qelizat A1 e B per metoden indirekte”, nga verifikimi i katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK konstatohet se në këtë katalog nuk pasqyrohen të gjitha specififikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues.

Në lidhje me artikullin nr.3 “Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO dhe DCT - neonat” në specififikimet teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar “1. Kartat duhet te permbajne anti-A, anti-B, anti-AB dhe anti-DVI+ me baze monoklonale. 2. Kartat duhet te permbajne edhe nje mikrotubul me AHG per DCT. 3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise. 4. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime. 5. Sasia e kerkuar bashkangjitur.”, ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK si dhe informacioni i dorëzuar nga ky i fundit pranë KPP-së ku citon “Artikulli Karta plastike për neonat – kodi 6901906 gjendet në faqen 63 të katalogut (Ortho)”, nga verifikimi konstatohet se, në katalogun “Ortho”, në faqen 63, në kodin 6901906 përcaktohet “ORTHO BioVue® Neëborn (A, B, AB, D, Control, AHG anti - IgG)”. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se “Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.3 “Karta plastike për neonat” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-B, anti-DVI+ dhe nje mikrotubul me AHG

per DCT”, nga verifikimi i katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK konstatohet se në këtë katalog nuk pasqyrohen të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues.

Në lidhje me artikullin nr.4 “Karta plastike me AHG – polispecifike (LISS/COOMBS)” në specifikimet teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar “1- Kartat duhet të jene të pershtatshme për t’u përdorur për: - Kontroll per antitropa, - Identifikim i antitropave, - Pajtueshmeri, - Test Coombs Direkt. 2- Kartat duhet të kene mikrotubula ne te cilin te jete shtuar AHG-polispecifike (me anti- IgG origjine animale dhe anti-C3d monoklonale). 3-Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise. 4- Sasia e kerkuar bashkangjitur”, ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK si dhe informacioni i dorëzuar nga ky i fundit pranë KPP-së ku citon “Artikulli Karta Coombs (AHG IgG+C3d) – kodi 707350 gjendet në faqen 63 të katalogut (Ortho)”, nga verifikimi konstatohet se, në katalogun “Ortho”, në faqen 63, në kodin 707350 përcaktohet “ORTHO BioVue® Anti-Human Globulin Polyspecific”. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se “Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.4 “Karta Coombs (AHG IgG+C3d)” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne AHG-polisferike (me anti-IgG origjine animale dhe anti-C3d monoklonale, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT”, nga verifikimi i katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK konstatohet se në këtë katalog nuk pasqyrohen të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues.

Në lidhje me artikullin nr.9 “Karta plastike për identifikimin e llojit të antitropave në DCT - pozitiv” në specifikimet teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar “1. Në mikrotubulat e kartes duhet të kete prezence të të pakten 4-reagent serave të ndryshem AHG-monospecifike: anti-IgG, dhe anti-C3d (monoklonale), 2 - Të kete dhe nje mikrotubul per kontrollin negativ. 3.Pamja e jashtme e kartave plastike duhet te jete me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise. 4- Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.”, ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK si dhe informacioni i dorëzuar nga ky i fundit pranë KPP-së ku citon “Artikulli Karta + reagent – sera, për DCT-screen (të paktën IgG dhe C3d) ka kodin 707165 gjendet në faqen 66 të katalogut (Ortho)”, nga verifikimi konstatohet se, në katalogun “Ortho”, në faqen 66 nuk gjendet artikulli sipas kodit të deklaruar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, ndërkohë në faqen 63 të katalogur Ortho pasqyrohet kodin 707165 ku përcaktohet “ORTHO BioVue® DAT/IDAT (AHG anti – IgG, anti – C3b & - C3d, Control”. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se “Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.9 “Karta + reagent sera, për DCT-screen (te pakten IgG dhe C3d)” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-IgG dhe anti-C3d (monoklonale) dhe nje mikrotub per kontrrollin negativ, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT”, nga verifikimi i katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK konstatohet se në këtë katalog nuk pasqyrohen të gjitha specifikimet teknike

të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues.

Sa më sipër argumentuar, konstatojmë se, disa nga specifikimet teknike të artikujve të mësipërm, nuk gjejnë pasqyrim në katalogët e dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, duke mos plotësuar kështu kërkesat e autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i ndryshuar, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi administrative, pasi referuar gjykimin më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Lasermed” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, me argumentin se: *“Kemi bindjen që operatori ekonomik Pegasus shpk i identifikuar si operator i sukseshem nuk ka plotësuar dhe nuk përmbush sipas detyrimeve ligjore deklaratimet: në formularin Permbledhës të Vetedeklarimit sipas Shtojcës 8, Pika C , tek kriteret e vecanta të kualifikimit. Pasi ky operator ekonomik ka disa adresa të ushtrimit të aktivitetit dhe gjykojmë se nuk ka paraqitur vertetim të OSHEE me ane të të cilit të vertetojë se ka shlyer të gjithë detyrimet e OSHEE për adresat e deklaruara në QKB. Te njejtin qëndrim ka mbajtur dhe KPP në vendimin Nr. 202/2021, datë 12.05.2021”*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 për Lotin 1 *“Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit ”* gërma “e” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet:

Ofertuesi deklaron se:

[...]

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (S.P.E) nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;
- Vërtetim debie nr. 835 prot., datë 10.05.2022, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) Z. J.K, vërtetojmë se Pegasus nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) TR2D....., TR2P16....., titullar i së cilës është Pegasus shpk rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 10.05.2022, pa përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2022;

III.3.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklaratimin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në një procedurë

prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjykojmë së, kërkesa se operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, është kërkuar nga autoriteti kontraktor të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik sipas shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit në respektim të nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të VKM, duke përmbushur kriterin kualifikues për këtë fazë, ku autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, në plotësimin e këtyre kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE): Formularin përmbledhës së Vetëdeklarimit për “Pegasus” SHPK, duke përmbushur kështu, në këtë moment kriterin kualifikues mbi disponimin e punonjësve për këtë fazë.

Akoma më tej, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, konstatohet se ky i fundit në përmbushje të kriterit në lidhje me vërtetimin e shlyerjes së energjisë elektrike, ka paraqitur Vërtetim debie nr. 835 prot., datë 10.05.2022, ku citohet: [...] *Bazuar në deklarinimet e deklaruësit (përfaqësuesit ligjor) Z. J.K, vërtetohet se Pegasus nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) TR2D....., TR2P16....., titullar i së cilës është Pegasus shpk rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 10.05.2022, pa përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2022. Pra, nëpërmjet këtij vërtetimi verifikohet se operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, nuk rezulton debitor pranë Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA, pa përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2022, për dy kontrata TR2D....., TR2P16..... Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrisë Tregtar të shoqërisë “Pegasus” SHPK, konstatohet se ky i fundit ushtron aktivitetin e tij në adresat Tirane Tirane TIRANE Rruga Siri Kodra, tek ish frigoriferi, Nr. 149, TIRANE Rruga Kongresi i Manastirit, Pallati i Ri 6 kateshe Kati 3, Brenda Qendres Spitalore Nene Tereza Tirane*

Sa më sipër, KPP gjykon, se Furnizuesi i Shërbimit Universal (OSHEE Group SHA) është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, kështu që rrjedhimisht, referuar vërtetimit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK rezulton 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, dy kontrata me adresë në Tiranë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK, nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Laser Med” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK me argumentin se “*Operatori ekonomik Pegasus shpk nuk përmbush kriteret e vecanta për kualifikim pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 3) në shtojcën përkatëse është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA ose deklarate konformiteti CE ose FDA (Aty ku është e aplikueshme) sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuara).*

Duke qene se Laser Med shpk ka nje eksperience te konsiderueshme ne trajtimin e artikujve/ mallrave objekt te prokurimit dhe, per rrjedhoje, eshte e informuar per kompanite prodhues te tyre, gamen e prodhimit dhe specifikimet teknike te tyre, insiston se jo per te gjithë artikujt ofertuesi ka paraqitur Certifikata konformiteti CE ose FDA, si dhe deklaratat e konformitetit qe mund te kete paraqitur ky operator ekonomik nuk perfshijne te gjithë artikujt qe mund te aplikohen.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, për Lotin 1, në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA ose deklarate konformiteti CE ose FDA (Aty ku eshte e aplikueshme) sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).*

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- EC Declaration of Conformity Hematies Reactivo - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210349, i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Tarjetas DG Gel/DG Gel Cards - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 213659; 210350; 210353; 210126; 210198; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity DG Gel Neutral 210320/210343- me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210343; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – K Mono – Type (2) – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 2135557; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – D Mono – Type– me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213005; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Tarjetas DG Gel/DG Gel Cards - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210342; 210345; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Sero – Cyte Pool 0.8 % – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213634; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Hematies Reactivo Lista B - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210206; 210210; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Essential II Control – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213287; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – A1 Lectin – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213437; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – H Mono – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213633; i përkthyer dhe i noterizuar;

- EC - Declaration of Conformity Anti – M for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213181; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – N for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213182; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Anti – S for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213183; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Anti – s for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213185; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Lea for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213217; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Lea for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213217; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Anti – Leb for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213219; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Anti – Jka for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213221; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Anti – Jkb for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213223; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Lu for DG Gel me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213294; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Lu Mono – Type Dual me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213295; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Fy for DG Gel 213206 me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213206; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Fy for DG Gel me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213207; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Kp^a Dual me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213995; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Kp^b Dual me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213996; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – P1 Mono – Type Dual Dual me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213292; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Bromelase 30 me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213578; i përkthyer dhe i noterizuar;

- EC - Declaration of Conformity DG Fluid me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 213679; 213678; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG Clean 213797 me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 213797; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG DG Sol (2x100ml) 210354 me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210354; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Erytra 210400 me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210400; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG Therm me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 213734; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Erytra me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210600; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG Reader Net me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210700; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG Spin me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210363; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Bromelase 30 me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213578; i përkthyer dhe i noterizuar;

III.4.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.4.4. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor

përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.4.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.4.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin Certifikata konformiteti CE ose FDA ose deklaratë konformiteti CE ose FDA (Aty ku është e aplikueshme) sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre (Dokumentat duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuar).

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, i cili shprehimisht kundërshton se “jo për te gjithë artikujt ofertuesi ka paraqitur Certifikata konformiteti CE ose FDA, si dhe deklaratat e konformitetit që mund të ketë paraqitur ky operator ekonomik nuk përfshijnë te gjithë artikujt që mund të aplikohen”, gjykojmë se operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Thëksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të

përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërbushje kriteri/kriteresh.

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësi të procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krahasim të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke iu referuar të gjithë kriterit të veçantë të kualifikimit duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kriterit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*. Pra, sa më sipër, operatori ekonomik ankimues ka ngritur pretendime për mospërbushje nga ana e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK të kriterit në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit, por pa përcaktuar elementët kontratë se ku bazon pretendimin e tij.

Kështu që, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues i cili shprehimisht kundërshton se *“jo për të gjithë artikujt ofertuesi ka paraqitur Certifikata konformiteti CE ose FDA, si dhe deklaratat e konformitetit që mund të kete paraqitur ky operator ekonomik nuk përfshijnë të gjithë artikujt që mund të aplikohen”*, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “Pegasus” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur shtojcën 2 “Lista e Çmimeve”, ku për secilin artikull ka përcaktuar referencën e produktit të ofruar, sipas kodeve përkatëse. Gjithashtu, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, në përbushje të kriterit të mësipërm ka dorëzuar në SPE Deklarata Konformiteti CE, për secilin nga artikujt e ofruar, duke markuar në këto kodet përkatëse sipas deklaramit në shtojcën 2 për secilin nga artikujt. Në këtë mënyrë, KPP referuar pretendimit të ankimuesit, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, konstaton se ka paraqitur deklarata konformiteti CE, për secilin nga artikujt, duke markuar në këto deklarata kodet

përkatëse të cilat përputhen me kodet e paraqitura si referencë për cdo artikull në Shtojcën 2, Lista e çmimeve.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Lasarmed” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK SHPK me argumentin se: **“Se treti:** *Operatori ekonomik Pegasus shpk nuk ploteson kriterin kualifikues të dhënë në pikën 2.3.5 të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, pasi nuk ka paraqitur katalogjet apo skedat teknike për artikujt me numer rendor NR. 4 “Karta Coombs (AHG IgG+C3d)” dhe Nr. 7 “Karta për Dëeak (Coombs anti-IgG)” të dhëna në Shtojcën 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” për Lot 1: “Karta, reagentë dhe aksesorë të tjerë për Laboratorin e Imuno-Hematologjisë në QKTGJ dhe Bankat e gjakut në Tiranë për shpërndarjen e pajisjeve në përdorim”.*

Se katërti: *Operatori ekonomik Pegasus shpk nuk ploteson kriterin kualifikues të dhënë në pikën 2.3.5 të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, pasi katalogjet e dorëzuar nuk plotësojnë specifikimet teknike të artikujve si më poshtë:*

a) *Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.1 “Karta plastike për Pacient” të ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se përmbajnë anti-A, anti-B dhe anti-D me baze monoklonale dhe 2-mikrotubula neutral për qelizat A₁ e B për metodën indirekte, sikurse është përcaktuar në Shtojcën 5 të DT ku është përcaktuar se: “Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe RhD (në një kartë të vetme – për pacient).*

1. **Kartat duhet të përmbajnë anti-A, anti-B dhe anti-D me baze monoklonale.**
2. **Kartat duhet të përmbajnë edhe 2-mikrotubula neutral për qelizat A₁ e B për metodën indirekte.**
3. *Të ketë gjithashtu edhe një mikrotubul për kontrollin negativ (Ctl).*
4. *Pamja e jashtme e kartave duhet të jetë me kolona transparente, pa plasaritje/tharje pa buleza ajri apo solucioni të shpërndarë nëpër tubula dhe të mos ketë çarje apo demtime të tjera të fletës vulosëse të sigurisë.*
5. *Reagentet qelizor A1 dhe B të jenë suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.*
6. *Pamja e jashtme: reagentet duhet të jetë pa turbullira, hemolizë apo precipitime.*
7. *Sasia e kërkuar bashkëgjithë.*

b) *Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr. 2 “Karta plastike për Dhurues” të ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se përmbajnë anti-B, anti-DVI+ dhe 2-mikrotubula neutral për qelizat A₁ e B për metodën indirekte, sikurse është përcaktuar në Shtojcën 5 të DT ku është përcaktuar se: “Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe përcaktimin e dyfishtë të RhD (në një kartë të vetme – për dhurues).*

1. **Kartat duhet të përmbajnë anti-A, anti-B, anti-DVI+ dhe anti-DVI- me baze monoklonale**

2. **Kartat duhet te permbajne edhe 2-mikrotubula neutral per qelizat A₁ e B per metoden indirekte.**
3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
4. Reagentet qelizor A₁ dhe B te jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
5. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
6. Sasia e kerkuar bashkangjitur”.

c) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr. 3 “Karta plastike për neonat” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-B, anti-DVI+ dhe një mikrotubul etj, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT ku eshte percaktuar se: “Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO dhe DCT – neonat

1. **Kartat duhet te permbajne anti-A, anti-B, anti-AB dhe anti-DVI+ me baze monoklonale.**
2. **Kartat duhet te permbajne edhe nje mikrotubul me AHG per DCT.**
3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
4. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
5. Sasia e kerkuar bashkangjitur.”

ç) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.6 “Karta per Rh fenotip + Kell” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-e dhe anti-K dhe nje mikrotub me AHG per DCT, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT ku eshte percaktuar se: “Karta plastike për fenotipin e Rh + Kell

1. **Kartat duhet te permbajne antitrupa monoklonale (me reagent-sera te inkorporuar ne mikrotubulat e kartes ose reagenti te shtohet ne to automatikisht ne momentin e testimi): anti-C, anti-c, anti-E, anti-e dhe anti-K**
2. **Kartat per perdorim pacienti duhet te kenë gjithashtu edhe një mikrotubul cti.**
3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
4. Sasia e kerkuar bashkangjitur.”.

d) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.8 “Karta për fenotip të zgjeruar (anti-k, anti-Fy_a, anti-Fy_b, anti-Jk_a, anti-Jk_b)” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-k, anti-M, anti-N, anti-S, anti-s, anti-Le^a, anti-Le^b, anti-Jk^a, anti-Jk^b, anti-Lu^a, anti-Lu^b, anti-Fy^a, anti-Fy^b, anti-Kp^a, anti-Kp^b dhe anti-P₁, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT ku eshte percaktuar se: “Karta plastike për përcaktimin e fenotipit të zgjeruar

1- Kartat duhet te kene te suspenduar anti-trupat korespondues ose reagent-sera te shtohet ne to automatikisht ne momentin e testimi) si me poshte:

- anti-k (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-M (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-N (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-S (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-s (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Lea (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Leb (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Jka (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Jkb (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Lua (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Lub (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti- Fya (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti- Fyb (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Kpa (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-Kpb (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- anti-PI (nese i disponueshem preferohen monoklonal)

2- Pamja e jashtme e kartave plastike duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vuloese te sigurise.

3- Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

e) Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.9 “Karta + reagent sera, pë DCT-screen (te pakten IgG dhe C3d)” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-IgG dhe anti-C3d (monoklonale) dhe nje mikrotub per kontrollin negativ, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT ku eshte percaktuar se: “Karta plastike për identifikimin e llojit të antitropave në DCT-pozitiv.

1- Në mikrotubulat e kartes duhet të kete prezence të të pakten 2-reagent serave të ndryshem AHG-monospecifike: anti-IgG dhe anti-C3d (monoklonale).

2. Të kete dhe nje mikrotubul per kontrollin negativ.

3. Pamja e jashtme e kartave plastike duhet te jete me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vuloese te sigurise.

4. Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.”.

Se Pesti: Operatori ekonomik Pegasus shpk gjithashtu nuk permbush kriteret e vecanta per kualifikim pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 6) eshte kerkuar:

ç) Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin

e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Ky operator ekonomik nuk ka markuar te gjithë elementet dhe specifikimet teknike te hollesishme per secilin artikull dhe nuk i ka markuar sipas numrit rendor, cka e ben te pamundur vleresimin e tyre si nga AK ashtu dhe KPP. “ Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 për Lotin 1 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

6. Kërkojen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).

III.5.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimet teknike” të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektornike përcaktohet si më poshtë:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Reagentë dhe aksesorë të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, perfshire pajisjet ne perdorim

<i>Nr</i>	<i>EMERTIMI</i>	<i>NJESIA</i>	<i>SASIA</i>
<i>1</i>	<i>Karta plastike për Pacient</i>	<i>Karta</i>	<i>25 000</i>
<i>2</i>	<i>Karta plastike për Dhurues</i>	<i>Karta</i>	<i>25 000</i>
<i>3</i>	<i>Karta plastike për neonat</i>	<i>Karta</i>	<i>3 000</i>

4	<i>Karta Coombs (AHG IgG+C3d)</i>	<i>Testime</i>	<i>12 500</i>
5	<i>Karta neutrale</i>	<i>Testime</i>	<i>1 200</i>
6	<i>Karta për Rh fenotip + Kell</i>	<i>Testime</i>	<i>15 200</i>
7	<i>Karta për Dëeak (Coombs anti-IgG)</i>	<i>Testime</i>	<i>2 000</i>
8	<i>Karta për fenotip të zgjeruar (anti-k, anti-Fya, anti-Fyb, anti-Jka, anti-Jkb)</i>	<i>Testime</i>	<i>100</i>
9	<i>Karta + reagent-sera, për DCT-screen (te pakten IgG, IgM, IgA, C3d)</i>	<i>Testime</i>	<i>60</i>
10	<i>Pool qelizor (me 2-qeliza, AHG)</i>	<i>Testime</i>	<i>10 000</i>
11	<i>Panel qelizor I-II-III (AHG)</i>	<i>Panel 3x10ml</i>	<i>10</i>
12	<i>Panel 11-qelizor (AHG)</i>	<i>Panel 11x4ml</i>	<i>10</i>
13	<i>Sete për Kontrollin e Cilësisë</i>	<i>set</i>	<i>10</i>
14	<i>Anti-A1</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
15	<i>Anti-H</i>	<i>teste</i>	<i>50</i>
16	<i>Anti – M</i>	<i>teste</i>	<i>50</i>
17	<i>Anti - N</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
18	<i>Anti - S</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
19	<i>Anti – s</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
20	<i>Anti Le^a</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
21	<i>Anti Le^b</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
22	<i>Anti Jk^a</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
23	<i>Anti Jk^b</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
24	<i>Anti Lu^a</i>	<i>teste</i>	<i>20</i>
25	<i>Anti Lu^b</i>	<i>teste</i>	<i>20</i>
26	<i>Anti Fy^a</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
27	<i>Anti Fy^b</i>	<i>teste</i>	<i>30</i>
28	<i>Anti Kp^a</i>	<i>teste</i>	<i>10</i>
29	<i>Anti Kp^b</i>	<i>teste</i>	<i>10</i>
30	<i>Anti P1</i>	<i>teste</i>	<i>10</i>

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE KARTAVE PLASTIKE, REAGENTEVE DHE AKSESOREVE TE TJERE TE NEVOJSHEM PER TESTIMET IMUNOHEMATOLOGJIKE.

Reagente dhe aksesore te tjere te nevojshem per testimet ne Laboratorin e Imuno Hematologjise (QKTGJ) dhe bankat e gjakut ne Tirane, se bashku me pajisjet ne perdorim.

Të përgjithshme

- 1- Te gjithë reagentet me origjine humane duhet te jene prej materiali baze (gjak dhe produktete tij) te testuar, qe rezulton negativ per anti-HIV, anti-HCV dhe HBsAg.
- 2- Per te gjithë reagentet qe ofrohen duhet te paraqiten specifikimet teknike te tyre (kataloge, flete shoqeruese e kartave dhe reagenteve).
- 3- **Mosparaqitja e specifikimeve teknike në dokumentet e paraqitura nga OE eshte kusht skualifikues.**
- 4- Afati i skadences per **kartat plastike** te jete te pakten **8 muaj** nga data e marrjes ne dorezim (levrimin te tyre).
- 5- Afati i skadences per te gjithë **Reagentet, sol. Holluese (Diluent)** dhe **sol. Shplares/Tretesit** te jete **mbi 12 muaj** nga koha e marrjes ne dorezim.
- 6- Afati i skadences per gjithë panelet dhe **Reagentet qelizor** te jete deri ne **4 jave** nga koha e marrjes se tyre ne dorezim.
- 7- Levrimi i kartave plastike te behet sipas kerkeses se institucionit dhe afateve respektive te skadencave. Levrimi i reagenteve/paneleve te tjere qelizor do te behet cdo muaj, sipas afateve perkatese te skadences apo kerkeses se institucionit.
- 8- **Amballazhi shishe qelqi me tape me/pa pikatore.**
- 9- **Etiketa duhet te jete e qendrueshme ndaj lageshtise se frigoriferit. Shkrimi te jete I qendrueshem deri ne fund te skadences.**

Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe RhD (në një kartë të vetme – për pacient).

9. Kartat duhet te permbajne **anti-A, anti-B** dhe **anti-D** me baze monoklonale.
10. Kartat duhet te permbajne edhe 2-mikrotubula neutral per qelizat **A₁** e **B** per metoden indirekte.
11. Të ketë gjithashtu edhe një mikrotubul per kontrollin negativ (Ctl).
12. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete me kolona transparente, pa plasaritje/tharje pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje apo demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
5. Reagentet qelizor **A1** dhe **B** te jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
6. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
7. Sasia e kerkuar bashkangjitur

Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe përcaktimin e dyfishtë të RhD (në një kartë të vetme – për dhurues).

7. Kartat duhet te permbajne **anti-A, anti-B, anti-DVI+** dhe **anti-DVI-** me baze monoklonale

8. Kartat duhet te permbajne edhe 2-mikrotubula neutral per qelizat **A₁** e **B** per metoden indirekte.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
4. Reagentet qelizor **A1** dhe **B** te jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
5. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
6. Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO dhe DCT – neonat

5. Kartat duhet te permbajne **anti-A**, **anti-B**, **anti-AB** dhe **anti-DVI+** me baze monoklonale.
6. Kartat duhet te permbajne edhe nje mikrotubul me AHG per DCT.
3. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
4. Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
5. Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike me AHG-polispecifike (LISS/COOMBS).

- 1- Kartat duhet të jene të pershtatshme për t'u përdorur për:
 - Kontroll per antitrupa
 - Identifikim i antitrupave
 - Pajtueshmeri
 - Test Coombs Direkt.
- 2- Kartat duhet të kene mikrotubula ne te cilin te jete shtuar AHG-polispecifike (me **anti- IgG** origjine animale dhe **anti-C3d** monoklonale).
- 5- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
- 4- Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike me suspension neutral.

- 1- Kartat plastike, duhet te jene te pershtatshme per t'u perdorur per:
 - Kontroll / Identifikim antitrupash (me metoden enzimatike)
 - Pajtueshmeri
 - Metoden indirekte te percaktimit te grupit.
 - Percaktimin e titrit te imunizimit (sipas hollimeve perkatese).
- 2- Kartat duhet te kene kolona me suspension neutral, te afta per te kapur reaksionet nga antitrupat reaktive me tekniken enzimatike dhe ate me saline.
- 3- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
- 6- Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike për fenotipin e Rh + Kell

11. Kartat duhet te permbajne antitrupa monoklonale (me reagent-sera te inkorporuar ne mikrotubulat e kartes ose reagenti te shtohet ne to automatikisht ne momentin e testimit): **anti-C, anti-c, anti-E, anti-e dhe anti-K**
12. Kartat per perdorim pacienti duhet te kenë gjithashtu edhe një mikrotubul ctl.
13. Pamja e jashtme e kartave duhet te jete me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
14. Sasia e kerkuar bashkangjitur.

Karta plastike që përmbajnë AHG (anti-IgG) për përcaktimin e D^{ëeak}

- 1- Kartat duhet te kene te shtuar antiglobuline humane, anti-IgG. Mund te perdoret edhe per qellime te tjera si: direkt/indirekt coombs test (kontroll / identifikim antitrupash e pajtueshmeri).
- 2- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
- 3- Reagenti per konfirmimin e D^{ëeak} me ane te ICT, te permbaje anti-D, IgG-monoklonal
- 4- Pamja e jashtme: Reagenti duhet te jete pa turbullira apo precipitime.
- 5- Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

Karta plastike për përcaktimin e fenotipit të zgjeruar

- 1- Kartat duhet te kene te suspenduar anti-trupat korespondues ose reagent-sera te shtohet ne to automatikisht ne momentin e testimit) si me poshte:
 - **anti-k** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-M** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-N** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-S** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-s** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-Le^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-Le^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-Jk^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-Jk^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-Lu^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-Lu^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti- Fy^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti- Fy^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-Kp^a** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-Kp^b** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
 - **anti-P₁** (nese i disponueshem preferohen monoklonal)
- 2- Pamja e jashtme e kartave plastike duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
- 3- Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

Karta plastike për identifikimin e llojit të antitrupave në DCT-pozitiv.

- 1 - Në mikrotubulat e kartes duhet të kete prezence të të pakten 4-reagent serave të ndryshem

AHG-monospecifike: **anti-IgG, anti-IgA, anti-IgM, dhe anti-C3d** (monoklonale)

2 - Të kete dhe nje mikrotubul per kontrollin negativ.

15. Pamja e jashtme e kartave plastike duhet te jete me xhelin transparent, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.

4 - Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

Panele qelizor për kontroll/identifikim të antitropave të parregullt

Pool qeliza për kontroll të antitropave të parregullt.

6. Pool-i qelizor per identifikimin e antitropave te parregullt te pacientet duhet te jete me origjine humane.
7. Qelizat e perdorura ne kete pool duhet te jene nga dhurues unik/te vetem, grup O.
8. Të kenë një përqendrim 0.8% ($\pm 0.1\%$) e te jene te pershtatshme per t'u perdorur në kartat plastike respektive.
9. Pamja e jashtme duhet te jete e paster pa trubullime, pa hemolize apo koagula.
10. Sasia duhet te jete sipas kerkeses.

Panel 3-qelizor për kontroll/identifikim të antitropave te parregullt

6. Paneli 3-qelizor per identifikimin e antitropave te parregullt te pacientet duhet te jete me origjine humane.
7. Qelizat e perdorura ne kete panel duhet te jene nga dhurues unik/te vetem, grup O.
8. Te kene nje përqendrim 0.8% ($\pm 0.1\%$) e te jene te pershtatshme per t'u perdorur ne kartat respektive me xhel.
9. Pamja e jashtme duhet te jete e paster pa trubullime, pa hemolize apo koagula.
10. Sasia duhet te jete sipas kerkeses.

Panel 11-qelizor për identifikimin e antitropave antieritrocitare.

Panele per identifikimin e antitropave anti-eritrocitare me sinjifikance klinike. Këto panele duhet të jene te tille qe te sigurojne nje shperndarje optimale te antigeneve per identifikimin e anti-trupave antieritrocitare.

Panelet te jene te pershtatshem per identifikimin e antitropave vetem me metoden AHG (anti-globuline humane). Kushtet të jenë si me poshte:

4. Të jene suspensione eritrocitare te pershtatshme per t'u perdorur me kartat plastike respektive.
5. Pamja e jashtme e tyre duhet te jete e paster pa trubullime, hemolize apo koagula.
6. Sasia duhet te jete nga 1 panel, me intervale mujore levrimi, sipas kerkeses.

Set për Kontrollin e Cilësisë (esencial/i perzgjedhshem)

1. Kërkohet të behet kontrolli i performances se instrumentave apo teknikave te perdorura per percaktimin e grupit te gjakut (direkt/indirekt), skrinimit per antitropa, me mostra gjaku me grup gjaku te njohur dhe antitropa te identifikuar paraprakisht. Këto kontrolle duhet të realizohen perpara fillimit te cdo dite pune.

2. Pamja e jashtme e tyre duhet te jete e paster pa trubullime, hemolize apo koagula.

3. Sasia duhet te jete nga 1 set me intervale te levrimit, sipas kerkeses.

SPECIFIKIMET TEKNIKE
per pajisjet qe do jene ne perdorim

Platforma në përdorim duhet të përbëhet nga dy pajisje (kryesore dhe back-up) të cilat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- l. Të jenë **tërësisht automatike** me centrifugë, inkubatorë, lexues dhe monitor të integruar në një njësi të vetme, se bashku me kompjuterat e nevojshem per rishikimin, validimin dhe transferimin e te dhenave.
- m. Të kenë kapacitet ngarkimi të mostrave jo më pak se 80 për pajisjen kryesore dhe jo më pak se 40 për pajisjen back-up.
- n. Të punojnë me **ngarkesë të vazhdueshme** dhe jo në batch.
- o. Të ofrojnë titrimin automatik për antitropa të parregullt në të paktën një prej pajisjeve në përdorim.
- p. Të ofrojë një kontroll cilësie esencial/të përzgjedhshëm
- q. Të ofrojnë STAT
- r. Të jenë të aftë të njohin diametra dhe madhësi të ndryshme tubash origjinale
- s. Të ofrojnë informacion në kohë reale mbi gjendjen e reagentëve dhe statusin e mostrave në testim e sipër duke përfshirë edhe sinjalet akustike.
- t. Të ofrojë pamje me resolution të lartë për një mënaxhim sa më të sigurtë të rezultateve.
- u. Të disponojnë sisteme efikase për evitimin e kontaminimit të kryqëzuar.
- v. Të sigurojë lidhjen LIS. Operatori Ekonomik merr përsipër shpenzimet e lidhjes së pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar.

Për një cilësi dhe siguri maksimale të këtyre rezultateve tepër sensitive DUHET që pajisjet në përdorim, kartat që do të përdoren në to dhe reagentët përkatës të jenë të së njëjtës kompani.

Pajisjet në përdorim për sistemin gjysmëautomatik duhet të jenë sa/si më poshtë:

- **Centrifugë (5cope)** e përshtatshme për centrifugimin e kartës për testim imunohematologjik. Me nje kapacitet jo me pak se 10 karta.
- **Inkubator (5 cope)** për inkubimin e kartave që të ketë interval të modifikueshëm te kohës sipas nevojave të laboratorit për testimet imunohematologjike.
- **Reader automatik (5 cope)** i kartave. Kjo pajisje duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - Të ofrojë mundësinë e paraqitjes në një monitor të rezultatit, mundesine për ndërhyrje të mjekut në interpretim dhe mundësinë e printimit të rezultatit.
 - Të ofrojë pamje me resolution të lartë për një menaxhim sa më të sigurtë të rezultateve.

- Të lexojë bar-code të mostrave të gjakut që do të testohen dhe të kartave mbi të cilat do të punohet.
- Të sigurojë lidhjen me LIS. Operatori Ekonomik merr përsipër shpenzimet e lidhjes së pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe te ofroje mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar

Për një cilësi dhe siguri maksimale të këtyre rezultateve tepër sensitive DUHET që pajisjet në përdorim, kartat që do të përdoren në to dhe reagentët përkatës të jenë të së njëjtës kompani.

III.5.3. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit, përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 5 SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE KARTAVE PLASTIKE, REAGENTEVE DHE AKSESOREVE TE TJERE TE NEVOJSHEM PER TESTIMET IMUNOHEMATOLOGJIKE.

Tek specifikimet teknike te pergjithshme, pika 4 dhe 5:

ISHTE...

4- Afati i skadences per kartat plastike te jete te pakten 8 muaj nga data e marrjes ne dorezim (levrimin te tyre)

5- Afati i skadences per te gjithë Reagentet, sol. Holluese (Diluent) dhe sol. Shplares / Tretesit te jete mbi 12 muaj nga koha e marrjes ne dorezim

BEHET

4- Afati i skadences per kartat plastike te jete te pakten 5 muaj nga data e marrjes ne dorezim (levrimin te tyre)

5- Afati i skadences per te gjithë Reagentet, sol. Holluese (Diluent) dhe sol. Shplares / Tretesit te jete mbi 8 muaj nga koha e marrjes ne dorezim

Tek specifikimet teknike te kartave plastike, pika 1:

ISHTE....

Karta plastike për identifikimin e llojit të antitropave në DCT-pozitiv.

1 - Në mikrotubulat e kartes duhet të kete prezence të të pakten 4-reagent serave të ndryshem AHG-monospecifike: anti-IgG, anti-IgA, anti-IgM, dhe anti-C3d (monoklonale)

BEHET

Karta plastike për identifikimin e llojit të antitropave në DCT-pozitiv.

1- Në mikrotubulat e kartes duhet të kete prezence të të pakten 2-reagent serave të ndryshem AHG-monospecifike: anti-IgG dhe anti-C3d (monoklonale)

Saktesimet e mesiperme jane pasqyruar edhe ne tabelen si meposhte tek pika nr.9.

ISHTE....

Reagentë dhe aksesore të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë pajisjet ne perdorim

<i>Nr</i>	<i>EMERTIMI</i>	<i>NJESIA</i>	<i>SASIA</i>
9	<i>Karta + reagent-sera, për DCT-screen (te pakten IgG, IgM, IgA, C3d)</i>	<i>Testime</i>	60

BEHET:

Reagentë dhe aksesore të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë pajisjet ne perdorim

<i>Nr</i>	<i>EMERTIMI</i>	<i>NJESIA</i>	<i>SASIA</i>
9	<i>Karta + reagent-sera, për DCT-screen (te pakten IgG dhe C3d)</i>	<i>Testime</i>	60

III.5.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Pegasus” SHPK në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojca 5 “Formulari i specifikimeve teknike”;
- Deklaratë nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK mbi origjinën dhe prodhuesin për artikujt e ofruar për këtë procedurë prokurimi;
- Shtojca 2 “Lista e çmimeve”, ku pasqyrohet nr i artikullit, përshkrimi i mallit, sasia, çmimi për njësi, çmimi total për artikull dhe referenca e produktit të ofruar sipas kodeve përkatëse;
- Letër autorizimi datë 11 maj 2022 lëshur nga Diagnostic Grifols S.A për Pegasus SHPK me përmbajtje si më poshtë: “...Diagnostic Grifols S.A, një kompani e inkuorporuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Spanjës, me adresën e saj të regjistruar në Poligono Levante c/ Can Guasch, s/n, 08150, Parets del Valles (Barcelona), Spanjë “Grifols”, vërteton se: Pegasus LTD, një kompani e inkuorporuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shqipërisë, me adresë të regjistruar në rrugën “Siri Kodra”, Nr.149, Tiranë, Shqipëri (“Pegasus”) autorizohet të paraqesë një ofertë në procesin e tenderit, n, Ref-25594-04-19-2022 (“Tenderi”) për produktet e mëposhtme të Testimit të Imunohematologjisë për analizën e gjakut dhe/ose të tregtuara nga Grifols, në përputhje me marrëveshjen e shpërndarjes të lidhur nga dhe ndërmjet, ndërmjet të tjerëve, Grifols dhe Pegasus me 1 Prill, 2016, i ndryshuar së fundi më 1 nëntor, 2016: Analizuesit e Ekzaminimit Imunohematologjik, Kartat, Reagentët dhe Solucionet Grifols sipas kërkesave të tenderit...”;
- Katalog “Grifols DGel”, nga GRIFOLS (i përkthyer dhe i noterizuar);

III.5.5. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.5.6. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.5.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.5.8. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor

përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.5.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objektin e kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.5.10 . Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.5.11. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë

integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.5.12. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe **parimin e kontradiktoritetit**.”*

Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me specifikimet teknike për artikullin 8.

III.5.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, ka përcaktuar specifikimet teknike të cilat duhet të përmbushin produktet objekt prokurimi. Gjithashtu, në “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 e “Kapacitetit teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. (Katalogët duhet të ngarkohen në eëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuara).

KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto artikuj.

III.5.14. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, Deklaratë mbi të dhënat për kompaninë origjinën dhe kompaninë prodhuese të mallit të ofruar, Shtojcën nr. 2 “Lista e çmimeve”, ku operatori ekonomik ka pasqyruar nr rendor të artikullit, përshkrimin e mallit, sasinë, çmimin për njësi, çmimin total për artikull dhe referenca e produktit të ofruar sipas kodeve përkatëse. Si dhe katalogët e markuar për secilin artikull sipas kodeve të deklaruara në Shtojcën 2 “Lista e Cmiveve”. Konkretisht Katalog “Grifols DGel”, nga Grifols (i perkthyer dhe i noterizuar).

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke qenë se KPP shfaqti vështirësi në evidentimin dhe verifikimin e specifikimeve teknike për të cilat operatori ekonomik

ankimues “Lasermed” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, për disa nga artikujt, tek katalogët dhe dokumentacioni i paraqitur nga ky i fundit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), KPP me anë të shkresë nr.1291/12 prot., datë 11.10.2022 i kërkoi operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, me qëllim gjykimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, të dorëzohet pranë KPP-së informacionin dhe faktet se në cilin katalog apo dokument (faqe, paragraf etj.), nga ato të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjenden artikujt me specifikimet teknike të lartpërmendura nga operatori ekonomik ankimues.

Me anë të shkresë të protokolluar me tonën me shkresën nr. 1291/13 prot, datë 13.10.2022 operatori ekonomik “Pegasus” SHPK ka dërguar informacion pranë Komisionit Prokurimit Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 1291/12 prot, datë 11.10.2022.

III.5.15. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, dokumentacioni i dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, si dhe sqarimet e vetë këtij të fundit dorëzuar pranë KPP-së, konstatohet se operatori ekonomik “Pegasus” SHPK ka paraqitur katalog të përkthyer dhe të notërizuar, në të cilin pasqyrohen të gjithë artikujt objekt prokurimi, si dhe janë markuar sipas kodeve përkatëse të deklaruara në shtojcën 2 për secilin nga artikujt. Gjithashtu, nga verifikimi i specifikimeve teknike për të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk përmbushen nga produktet e ofruara nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, konkretisht për pretendimet se *“Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.1 “Karta plastike për Pacient” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-A, anti-B dhe anti-D me baze monoklonale dhe 2-mikrotubula neutral per qelizat A1 e B per metoden indirekte, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5 te DT; Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr. 2 “Karta plastike për Dhurues” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-B, anti-DVI+ dhe 2-mikrotubula neutral per qelizat A1 e B per metoden indirekte, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5; Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr. 3 “Karta plastike për neonat” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-B, anti-DVI+ dhe një mikrotubul etj, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5; Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.6 “Karta per Rh fenotip + Kell” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-e dhe anti-K dhe nje mikrotub me AHG per DCT, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5; Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.9 “Karta + reagent sera, për DCT-screen (te pakten IgG dhe C3d)” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-IgG dhe anti-C3d (monoklonale) dhe nje mikrotub per kontrrollin negativ”,* KPP nga verifikimi i katalogut “Grifols DGel”, nga GRIFOLS (i përkthyer dhe i noterizuar), konstaton se për secilin artikull të mësipërm, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, ka markuar në katalog specifikimet, të cilat janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Ndërkohë për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik “Lasermed” SHPK në lidhje me artikullin nr.8 se *“Skeda teknike e artikulli me numer rendor Nr.8 “Karta për fenotip të zgjeruar (anti-k, anti-Fya, anti-Fyb, anti-Jka, anti-Jkb)” te ofertuar nga ky OE nuk vërtetojnë se permbajne anti-k, anti-M, anti-N, anti-S,anti-s, anti-Lea, anti-Leb, anti-Jka, anti-Jkb, anti-Lua, anti-Lub, anti- Fya, anti- Fyb, anti-Kpa, anti-Kpb dhe anti-P1, sikurse eshte percaktuar ne Shtojcen 5”,* KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, konstaton se në shtojcën 2 “Lista e cmimeve”, ky operator për këtë produkt ka deklaruar se e përmbush me dy artikujt me kod 210342 dhe 210343 të cilët respektivisht janë artikujt “Karta Coombs (AHG IgG + C3d)” dhe “Karta neutrale”, si dhe ka markuar në katalog të

gjithë Reagentët (anti-k; anti-M; anti-N; anti-S; anti-s; anti-Lea; anti-Leb; anti-Jka; anti-Jkb; anti-Lua; anti-Lub; anti- Fya; anti- Fyb; anti-Kpa; anti-Kpb; anti-P1).

Me anë të shkresës, të protokolluar pranë KPP-së nr. 1291/13 prot, datë 13.10.2022, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK ka dërguar informacion pranë Komisionit Prokurimit Publik, në lidhje me objektin e kërkesës nr. 1291/12 prot, datë 11.10.2022, ku ndër të tjera për artikullin “Karta plastike për përcaktimin e fenotipit të zgjeruar” përcakton: “...Përgjigje konfirmuese: Është ofruar artikulli 210342 DG Gel Coombs në fq 8 që (sipas alternativës të kërkuar në DST) përdoret me artikujt e mëposhtëm antisera që shtohen automatikisht në kartë nga aparati sipas llojit të testit të kërkuar:

Lista e antiserave për DG Gel Cards fq 13. Përfshihen të gjithë artikujt me nr. 14 -31 të lista e artikujve të kërkuar në DST. Duket qartë në katalog se edhe antisera 213209 Anti k Mono – type mund të përdoret në këtë kartë, por për arsye se nuk është e përfshirë në listën e antiserave të kërkuara në DST, nuk është markuar nga ana jonë në katalog në faqen 13, por është treguar në këtë sqarim.

- anti-k (nese i disponueshem preferohen monoklonal) 213209
- anti-M (nese i disponueshem preferohen monoklonal) 213181
- anti-N (nese i disponueshem preferohen monoklonal)213182
- anti-S (nese i disponueshem preferohen monoklonal)213183
- anti-s (nese i disponueshem preferohen monoklonal)213185
- anti-Lea (nese i disponueshem preferohen monoklonal)213217
- anti-Leb (nese i disponueshem preferohen monoklonal)213219
- anti-Jka (nese i disponueshem preferohen monoklonal)213221
- anti-Jkb (nese i disponueshem preferohen monoklonal 211223
- anti-Lua (nese i disponueshem preferohen monoklonal) 213294
- anti-Lub (nese i disponueshem preferohen monoklonal) 213295
- anti- Fya (nese i disponueshem preferohen monoklonal) 213206
- anti- Fyb (nese i disponueshem preferohen monoklonal) 213207
- anti-Kpa (nese i disponueshem preferohen monoklonal) 213995
- anti-Kpb (nese i disponueshem preferohen monoklonal) 213996
- anti-P1 (nese i disponueshem preferohen monoklonal) 213292

Të gjithë artikujt janë markuar në katalogun Grifols (DG Gel One System Many solution). Për lehtësi orientimi për KPP, u bë nga ana jonë edhe numërtimi I specifikimeve teknike.”

Për shkak të specifikës së kësaj procedurë prokurimi dhe vështirësisë në evidentimin e mënyrës së përmbushjes së specifikimeve teknike për artikullin 8, KPP në datën 24.10.2022, ora 12:00 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, zhvilloi një Seancë Dëgjimore midis operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, përfaqësuesve të autoritetit kontraktor (një specialist i fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave Prof.aAsoc. znj. I.S, si dhe pjesëmarrjen e një specialisti/eksperti sipas fushës së ekspertizës përkatëse, i cili nuk ishte përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit Dr. R.Gj) dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, ku për specialistin e autoritetit kontraktor pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave nga ana e KPP u shtrua pyetja “Ju lutem sqaroni në nivel teknik si është vlerësuar oferta e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për specifikimet teknike në lidhje me artikullin 8 “Karta plastike për fenotim të zgjeruar””.

Specialisti pjesë e Komisionit të Vlerësimit të ofertave në përgjigje të pyetjes së mësipërme deklaroi se *“Nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e kualifikimit, specifikimet teknike për artikullin 8 “Karta plastike për përcaktimin e fenotipit të zgjeruar”, kërkohet të realizohen në dy mënyra ku kartat duhet të kenë të suspenduar anti – trupat korrespondues ose reagent – sera të shohet në to automatikisht në momentin e testimit. Në rastin konkret, nga Kompania Grifols, produktet e të cilat ka ofruar “Pegasus” SHPK, është konstatuar se ky specifikim përmbushet nëpërmjet kartave neutrale kartave ahg në varësi të reagentëve që shtohen. Karta neutrale dhe e gjithë lista e reagentëve të ofruar bëjnë që ky specifikim të përmbushet. Nga autoriteti kontraktor është lënë e hapur mundësia që për artikullin 8, këto karta të kenë të inkuorporuar në trup reagentët ose këto reagentë shtohen. Opsioni që ofron kompania Grifols me operatorin ekonomik “Pegasus” SHPK është karta me shtimin e reagentëve. Nga ana jonë ky kriter është kërkuar në mënyrë të zgjeruar.”*

Gjithashtu në seancën degjimore, specialisti/eksperti i fushës, i cili nuk ka qenë pjesë e procedurës së prokurimit, Dr. R.GJ, deklaroi se *“Opsioni i ofruar nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, teknikisht ofron një rezultat të njëjtë për sa i përket cilësisë. Madje ky opsion i shërben autoritetit kontraktor në ato raste kur analiza duhet të kryhet manualisht.”*

Ndërkohë, përfaqësues të operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK deklarojnë në seancën degjimore se *“Për artikullin 8, ne kemi paraqitur dy kartat me kode 210342 dhe 210343. Kompania Grifols, për artikullin 8 ofron opsionin që reagentët të shtohen mbi karta dhe të japë rezultatin. Cdo kartë është krijuar për të inkuorporuar në karta llojin e reagentëve me qëllim marrjen e rezultatit. Sasia e reagentëve konkludohet e sasinë e kartave, domethën karta + reagent përbëjnë artikullin 8.”*

Sa më sipër, KPP nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, verifikimi i katalogëve të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, sqarimeve dhe argumentave të dorëzuara nga ky i fundit pranë KPP, si dhe deklarimeve të specialistëve të fushës në seancën degjimore të mbajtur në datë 24.10.2022, KPP gjykon se, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me artikullin nr.8.

Konkretisht, vetë specialisti i autoritetit kontraktor pjesë e procedurës së prokurimit deklaroi se përmbushja e specifikimeve teknike për artikullin 8 është kërkuar në mënyrë të zgjeruar, ku lejohet mundësia që kartat të kenë të suspenduar anti – trupat korrespondues ose reagent – sera të shohet në to automatikisht në momentin e testimit. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik për artikullin 8 ka ofruar opsionin që reagentët të shtohen mbi kartat për dhënien e rezultatit, duke përmbushur kështu kërkesën e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, vlen të theksojmë se, mjeku specialist i fushës Dr. R.Gj, i pranishëm në seancën degjimore, e cila nuk ka qenë pjesë e procedurës së prokurimit objekt ankimi, deklaroi se opsioni i ofruar nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, teknikisht ofron një rezultat të njëjtë për sa i përket cilësisë, madje ky opsion i shërben më mirë autoritetit kontraktor në ato raste kur analiza duhet të kryhet manualisht.

Sa më sipër argumentuar, gjykojmë se operatori ekonomik “Pegasus” SHPK me anë të dokumentacionit të paraqitur vërteton se artikujt e ofruar nga ky i fundit janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Lasermed” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, me argumentin se “[...]Se Gjashti: OE Pegasus nuk ka dorëzuar autorizimet përkatëse (nga kompania prodhuesi ose distributor i autorizuar) Kitet dhe pajisjet e kerkuara produktet shume specifike, aktualisht ne treg jane vetem disa prodhues dhe ne pergjithesi eshte e veshtire te mbuloje kete game artikujsh, dhe sidomos ne te njejtin aparat. Ofrimi i te gjithë kartave, reagenteve dhe aksesoreve si dhe pajisjeve ne perdorim per te beret e mundur realizimin e kesaj procedure kerkon me shume se nje kompani prodhuese/autorizim prodhuesi ose distributor i autorizuar. Ne dijenin tone, Pegasus eshte distributor i Grifols por kjo kompani nuk na rezulton tem und te realizoje plotesisht artikujt e kerkuar.

Operatori ekonomik Pegasus shpk nuk ploteson kriterin kualifikues te dhene ne pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të Shtojces 7 te dokumentave te tenderit, pasi nuk ka paraqitur autorizime prodhuesi dhe autorizime nga distributor te autorizuar per te gjithë prodhuesit (e mallrave objekt prokurimi te ofertuara per tij) qe ka deklaruar ne kete tender ne permbushje te kriterit kualifikues te dhene ne piken 2.3.1 te Shojces 7 te DT ku eshte percaktuar se: “1. Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese.” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 për Lotin 1 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3 dhe 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, si dhe pikën b në paragrafin “Për pajisjet që vë në përdorim pranë QKTGjakut”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).
4. Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).

Per Paisjet qe ve ne perdorim prane QKTGjakut :

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për ofrimin e paisjeve te kerkuara ne funksion te perdorimit te testeve nga AK sipas specifikimeve teknike te DT . (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës. (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara).

III.6.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Deklaratë nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK mbi origjinën dhe prodhuesin për artikujt e ofruar për këtë procedurë prokurimi ku citon: “Artikujt e ofruar nga kompania

Pegasus shpk kanë si prodhues dhe origjinë: Grifols/Spanjë, Medion Grifols/Zvicër, Antitoxin GmbH/Gjermani (Grifols Distributor)”

- Letër autorizimi datë 11 maj 2022 lëshur nga Diagnostic Grifols S.A për Pegasus SHPK me përmbajtje si më poshtë: “...*Diagnostic Grifols S.A, një kompani e inkuorporuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Spanjës, me adresën e saj të regjistruar në Poligono Levante c/ Can Guasch, s/n, 08150, Parets del Valles (Barcelona), Spanjë “Grifols”, vërteton se: Pegasus LTD, një kompani e inkuorporuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shqipërisë, me adresë të regjistruar në rrugën “Siri Kodra”, Nr.149, Tiranë, Shqipëri (“Pegasus”) autorizohet të paraqesë një ofertë në procesin e tenderit, n, Ref-25594-04-19-2022 (“Tenderi”) për produktet e mëposhtme të Testimit të Imunohematologjisë për analizën e gjakut dhe/ose të tregtuara nga Grifols, në përputhje me marrëveshjen e shpërndarjes të lidhur nga dhe ndërmjet, ndërmjet të tjerëve, Grifols dhe Pegasus me 1 Prill, 2016, i ndryshuar së fundi më 1 nëntor, 2016: Analizuesit e Ekzaminimit Imunohematologjik, Kartat, Reagentët dhe Solucionet Grifols sipas kërkesave të tenderit...”;*
- EC Declaration of Conformity Hematies Reactivo - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210349, i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Tarjetas DG Gel/DG Gel Cards - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 213659; 210350; 210353; 210126; 210198; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity DG Gel Neutral 210320/210343- me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210343; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – K Mono – Type (2) – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 2135557; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – D Mono – Type– me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213005; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Tarjetas DG Gel/DG Gel Cards - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210342; 210345; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Sero – Cyte Pool 0.8 % – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213634; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Hematies Reactivo Lista B - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210206; 210210; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Essential II Control – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213287; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – A1 Lectin – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213437; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – H Mono – me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213633; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Anti – M for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213181; i përkthyer dhe i noterizuar;

- Declaration of Conformity Anti – N for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213182; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Anti – S for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213183; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Anti – s for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213185; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Lea for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213217; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Lea for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213217; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Anti – Leb for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213219; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Anti – Jka for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213221; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Anti – Jkb for card method – me prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, për produktet me kod të markuar 213223; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Lu for DG Gel me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213294; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Lu Mono – Type Dual me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213295; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Fy for DG Gel 213206 me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213206; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Fy for DG Gel me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213207; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Kp^a Dual me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213995; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – Kp^b Dual me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213996; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Anti – P1 Mono – Type Dual Dual me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213292; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Bromelase 30 me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213578; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG Fluid me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 213679; 213678; i përkthyer dhe i noterizuar;

- EC - Declaration of Conformity DG Clean 213797 me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 213797; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG DG Sol (2x100ml) 210354 me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210354; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Erytra 210400 me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210400; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG Therm me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 213734; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity Erytra me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210600; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG Reader Net me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210700; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC - Declaration of Conformity DG Spin me prodhues Diagnostic Grifols S.A, për produktet me kod të markuar 210363; i përkthyer dhe i noterizuar;
- Declaration of Conformity Bromelase 30 me prodhues Medion Grifols Diagnostics AG, për produktet me kod të markuar 213578; i përkthyer dhe i noterizuar;

III.6.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.6.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e

veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.6.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuar). Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuar). Gjithashtu për pajisjet që vë në përdorim autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për ofrimin e paisjeve të kërkuara në funksion të përdorimit të testeve nga AK sipas specifikimeve teknike të DT . (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuar). Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës. (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuar).

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimes “Pegasus” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur një deklaratë në lidhje me origjinën dhe prodhuesin për artikujt e ofruar për këtë procedurë prokurimi ku citon: “Artikujt e ofruar nga kompania Pegasus shpk kanë si prodhues dhe origjinë: Grifols/Spanjë, Medion Grifols/Zvicër, Antitoxin GmbH/Gjermani (Grifols Distributor)”.

Gjithashtu, në përmbushje të kriterit të mësipërm konstatohet se autoriteti kontraktor ka paraqitur Letër autorizimi datë 11 maj 2022 lëshur nga Diagnostic Grifols S.A për Pegasus SHPK me përmbajtje si më poshtë: “...Diagnostic Grifols S.A, një kompani e inkuorporuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Spanjës, me adresën e saj të regjistruar në Poligono Levante c/ Can Guasch, s/n, 08150, Parets del Valles (Barcelona), Spanjë “Grifols”, vërteton se: Pegasus LTD, një kompani e inkuorporuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shqipërisë, me adresë të regjistruar në rrugën “Siri Kodra”, Nr.149, Tiranë, Shqipëri (“Pegasus”) autorizohet të paraqesë një ofertë në procesin e tenderit, n, Ref-25594-04-19-2022 (“Tenderi”) për produktet e mëposhtme të Testimit të Imunohematologjisë për analizën e gjakut dhe/ose të tregtuara nga Grifols, në përputhje me

marrëveshjen e shpërndarjes të lidhur nga dhe ndërmjet, ndërmjet të tjerëve, Grifols dhe Pegasus me 1 Prill, 2016, i ndryshuar së fundi më 1 nëntor, 2016: Analizuesit e Ekzaminimit Imunohematologjik, Kartat, Reagentët dhe Solucionet Grifols sipas kërkesave të tenderit...". Pra nëpërmjet dokumentit të mësipërm operatori ekonomik "Pegasus" SHPK vërteton se është i autorizuar nga kompania Grifols për të ofruar në këtë tender produktet si Analizuesit e Ekzaminimit Imunohematologjik, Kartat, Reagentët dhe Solucionet Grifols.

Për sa i përket, deklaratës së operatorit ekonomik "Pegasus" SHPK se në këtë procedurë ka ofruar dhe produkte të prodhuesit Antitoxin GmbH/Gjermani, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Pegasus" SHPK, konstaton se ky i fundit për artikujt reagentë të listuar në shtojcën 2 "Lista e çmimeve", me numër rendor 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, ka paraqitur deklaratat e konformitetit për secilin nga artikujt e cituar më lart, ku pasqyrohet prodhues Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, duke vërtetuar kështu lidhjen midis prodhuesit Antitoksina GmbH dhe distributor Grifols, si dhe duke përmbushur kërkesën e autoritetit kontraktor që në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

Gjithashtu, për sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor për paraqitjen e *autorizimit nga kompania prodhuese ose nga Distributor i Autorizuar nga prodhuesi, për ofrimin e paisjeve të kërkuara në funksion të përdorimit të testeve nga autoriteti kontraktor sipas specifikimeve teknike të DT. Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës. Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuara, në lidhje me pajisjet që do të vëre në përdorim pranë QKTGjakut, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatorit ekonomik "Pegasus" SHPK, i lindi e nevojshme sqarimi i mëtejshëm në lidhje me mënyrën e përmbushjes së kësaj kërkesë nga operatori ekonomik "Pegasus" SHPK. Për këtë arsye, në seacën degjimore të mbajtur midis palëve në datë 24.10.2022, KPP iu drejtua përfaqësuesve të operatorit ekonomik "Pegasus" SHPK me pyetjen se "Me cilin dokument të dorëzuar në SPE për këtë procedurë përmbushet kriteri i mësipërm nga ana juaj?" të cilët deklaruan se "Autorizimi për pajisjet gjendet në dokumentin Letër autorizimi datë 11 maj 2022 lëshur nga Diagnostic Grifols S.A për Pegasus SHPK me përmbajtje si më poshtë: "...Diagnostic Grifols S.A, një kompani e inkuorporuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Spanjës, me adresën e saj të regjistruar në Poligono Levante c/ Can Guasch, s/n, 08150, Parets del Valles (Barcelona), Spanjë "Grifols", vërteton se: Pegasus LTD, një kompani e inkuorporuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shqipërisë, me adresë të regjistruar në rrugën "Siri Kodra", Nr.149, Tiranë, Shqipëri ("Pegasus") autorizohet të paraqesë një ofertë në procesin e tenderit, n, Ref-25594-04-19-2022 ("Tenderi") për produktet e mëposhtme të Testimit të Imunohematologjisë për analizën e gjakut dhe/ose të tregtuara nga Grifols, në përputhje me marrëveshjen e shpërndarjes të lidhur nga dhe ndërmjet, ndërmjet të tjerëve, Grifols dhe Pegasus me 1 Prill, 2016, i ndryshuar së fundi më 1 nëntor, 2016: Analizuesit e Ekzaminimit Imunohematologjik, Kartat, Reagentët dhe Solucionet Grifols sipas kërkesave të tenderit...", **Termi "Analizuesit e Ekzaminimit Imunohematologjik", janë pajisjet që ofrohen."***

Sa më sipër, referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Pegasus" SHPK, si dhe deklarimeve në sencë degjimore të mbajtur në datë 24.10.2022, gjykojmë se me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik "Pegasus" SHPK përmbush kriterin e përcaktuar në pika 2.3.3 dhe 2.3.4 "Kapaciteti teknik", si dhe pikën b në paragrafin "Për pajisjet

që vë në përdorim pranë QKTGjakut”, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin “[...]Operatori ekonomik Pegasus shpk nuk ploteson kriterin kualifikues të dhene në pikën “a” të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit në pjesën “Per Paisjet që ve në përdorim pranë QKT Gjaket:”, pasi nuk ka paraqitur Autodeklarate ku saktësohet nr. dhe tipi i analizatoreve përfshirë aksesoret e tij të cilët OE do të instalojë duke bashkelidhur materialin përshkrues: lloji i paisjes, modeli, viti i prodhimit, kompania prodhuese, vendi i prodhimit, gamen e plote të analizave të cilat propozon dhe është në gjendje të bëjë sistemi, sikurse përcaktohet në këto kriter kualifikues”, vërej se:

III.7.1. Në shtojcën 7, “Kapaciteti teknik” në pjesën “Për Paisjet që vë në përdorim pranë QKTGjakut” pika b, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Për Paisjet që vë në përdorim pranë QKTGjakut:

a. Autodeklarate ku saktësohet nr. dhe tipi i analizatoreve përfshirë aksesoret e tij të cilët OE do të instalojë duke bashkelidhur materialin përshkrues:

- lloji i paisjes, modeli, viti i prodhimit, kompania prodhuese, vendi i prodhimit, gamen e plote të analizave të cilat propozon dhe është në gjendje të bëjë sistemi

Shenim. Apartura dhe aksesoret të jenë sipas specifikimeve teknike të DS. Gjithashtu të ofrohet një sistem back up i aparaturës shoqëruar me listen e aksesoreve të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, të reagentëve dhe afatit të levrimit të pasqyruara në DS.”

III.7.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Pegasus” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi Pajisjen, nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, datë 20.05.2022, me përmbajtje si vijon:

“...Kompania Pegasus shpk do të ofrojë dhe pajisjet e mëposhtme gjatë të gjithë kohës së kontratës bashkë me sasinë e testeve të kërkuara në tender dhe do të trajtojë stafin e QKTGjakut për përdorimin e këtyre aparaturave

1. Grifols Erytra (sistem automatik)

1 sistem

Analizator automatik me kapacitet të lartë për identifikimin e grupeve të gjakut ABO/Rh, Rh + Kell phenotipizim, Crossmatching test, Screening dhe identifikim për antibody të papritur, Titrim antibody, Enzime assay, Coombs test direct, përcaktim i antigeneve special

2. Grifols Erytra Eflexis (sistem automatik back – up) 1 sistem

Analizator automatik me kapacitet të mesëm për identifikimin e grupeve të gjakut ABO/Rh, Rh + Kell phenotipizim, Crossmatching test, Screening dhe identifikim për antibody të papritur, Titrim antibody, Enzime assay, Coombs test direct, përcaktim i antigeneve special

- | | |
|--|--------|
| 3. Grifols DG Spin (centrifugë) | 5 copë |
| 4. Grifols DG Therm (Inkubator) | 5 copë |
| 5. Grifols DG Readernet (Reader automatic) | 5 copë |

Kompania prodhuese Grifols dhe vendi i prodhimit Spanjë.

Viti I Prodhimit: 2021 – 2022

III.7.3. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin një *autodeklaratë ku saktësohet nr. dhe tipi i analizatorëve përfshirë aksesorët e tij të cilët OE do të instalojë duke bashkëlidhur materialin përshkrues: lloji i paisjes, modeli, viti i prodhimit, kompania prodhuese, vendi i prodhimit, gamën e plotë të analizave të cilat propozon dhe është në gjendje të bëjë sistemi.*

Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për mospërbushje të këtij kriteri nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga ky i fundit për përmbushjen e kriterit të mësipërm, konstatohet se operatori ekonomik “Pegasus” SHPK ka paraqitur një vetëdeklarim ku merr përsipër se do të ofrojë pajisjet e kërkuara gjatë të gjithë kohës së kontratës së bashku me sasinë e testeve të kërkuara në tender, si dhe do të trajtojë stafin e QKTGjakut për përdorimin e këtyre aparaturave. Gjithashtu operatori ekonomik “Pegasus” SHPK ka deklaruar në këtë dokument numrin dhe tipin e analizatorëve duke përfshirë aksesorët e tij (1 sistem automatik dhe 1 sistem automatik back up), llojet e pajisjeve, numri e tyre, kompaninë e prodhimit, vendin e prodhimit, vitin e prodhimit, si dhe gamën e plotë të analizave të cilat propozon dhe është në gjendje të bëjë sistemi.

Pra sa më sipër, duke qenë se autoriteti kontraktor, në kriteret e kualifikimit ka kërkuar shprehimisht përmbushjen e këtij kriteri me anë të një deklaratë nga operatori ekonomik i cili pretendon të fitojë kontratën, konstatohet se operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, me dokumentacionin e paraqitur e ka përmbushur këtë kriter.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se *“Gjithashtu operatori ekonomik Pegasus shpk, me vlerën me te ulet nuk përmbush kërkesat e nenit 93, të LPP-së për oferte anomalisht të ulet, pasi dokumentacioni analize kosto e paraqitur prej tij nuk justifikon ofertën e tij anomalisht të ulet sipas percaktimeve të bera në nenin 93 të LPP.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. 167/23 prot., datë 01.07.2022, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “Pegasus” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte në shkresën e mësipërme, autoriteti kontraktor deklaroi se *“Në zbatim të nenit 93, në datë 26.05.2022, nëpërmjet SPE, iu kërkuar ofertuesit Pegasus të paraqesë shpjegimet me shkrim brenda 3 ditë pune, për të argumentuar ofertën anomalisht të ulët”*.

III.8.2. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se, në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor, më datë 30.05.2022 operatori ekonomik “Pegasus” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur në mënyrë shkresore dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresë nr. 0107/22 prot., datë 30.05.2022, me objekt: “Përgjigje për sqarim të ofertës anomalisht të ulët”, protokolluar në autoritetin kontraktor me nr. 167/7 prot., datë 30.05.2022.

Në këtë shkresë, ndër të tjera, citohet se: “[...]Shoqëria Pegasus shpk është një ndër operatorët ekonomikë më të mëdhenj që operon në këtë fushë në tregun shqiptar prej më shumë se 25 vjetësh. Si një ndër importuesit dhe distributorët më të mëdhenj në vend, Pegasus shpk ka pasur një rritje të qëndrueshme në këtë biznes, duke demonstruar se ofron për klientët si publikë dhe privatë cilësi maksimale eficientë dhe siguri të padiskutueshme.

Elementët e furnizimit të ofruar nga ana jonë për AK në këtë procedurë janë:

- Furnizimi për një periudhë 12 mujore i AK me Reagentë dhe aksesore të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, sipas listës së artikujve me specifikimet dhe sasi të përcaktuara në Specifikimet Teknike në Dokumentat e Tenderit (DT).
- Dhënia dhe vënia në përdorim për një periudhë 12 mujore e pajisjeve të kërkuara nga AK, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara prej AK në DT.

Në zbatim të nenit 93 pika 1 dhe 2 të LPP dhe nenit 82 të VKM, i ndryshuar, në vijim të kërkesës suaj, po ju paraqesim argumentin e ofertës sonë në këtë procedurë, e konstatuar si ofertë anomalisht e ulët.

Sic përcakton neni 93 i LPP, në mënyrë të detajuar dhe të shoqëruar me dokumenta provuesm shpjegimet tona do të jepen në lidhje me plotësimin në mënyrë kumulative të kushteve të mëposhtme:

- a) Ana ekonomike e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndertimit;

Fillimisht duhet të theksojmë se PEGASUS. sh.p.k., nuk është prodhues i mallrave të ofruara, por distributor i tyre i drejtperdrejt nga prodhuesi, konkretisht shoqëria Grifols S.A.

Nga pikepamja e ndertimit të ofertës financiare, sqarojmë se në këto lloj furnizimi, kostot totale janë të kompozuar nga kostot fikse dhe kostot operative.

Kostot indirekte, të cilat janë të pandryshueshme dhe perbehen nga: shpenzime qeraje, kancelari zyre, telefoni & internet, energji, ujë, pastrim, shpenzime karburanti, shpenzime të tjera administrative si noterizime, perkthime etj. Në total kjo kategori kostosh perben rreth 1 % të kostove totale të ofertës.

Kostot direkte që perbejnë pjesën tjetër, janë ngushtesisht të lidhura me furnizimin specifik të ofruar. Me konkretisht, kostot direkte për ofertën tona në këtë procedurë janë si vijon:

1. Kosto e Blerjes Karta + Reagente + Antisera + Calibrator + Cntr. - rreth 52.1 % të kostove totale
2. Kostot e blerjes së pajisjeve të kërkuara - rreth 43.6 % të kostove totale
3. Shpenzime transporti dhe siguracioni në transport - rreth 1.1 % të kostove totale
4. Shpenzime agjenci dhe magazinimi doganore — rreth 0.2 % të kostove totale
5. Kosto personeli (pikë kontakti, suport teknik & kënaqësi) — rreth 1,8 % të kostove totale

6. Shpenzime Regjistrimi pranë agjencisë AKBPM – rreth 0.2 % e kostove totale

1 Termat e levrimit nga Grifols jam Free Carrier (FCA), pra nga kostot e transportit nga vendi i origjines (Sponja) dhe te siguracionit perkates, jane te shoqërisë Pegasus në cilesinë e blerësit.

2 Furnitori Grifols, eshte angazhuar qe nje ngo pajisjet (Erytra) ta ofroje pa kosto (me vlere o). Shiko Prova 1 - "Oferta e Grifols per Pegasus date 17/05/2022

3 Produktet ne fjale transportohen nepermjet tokes. Keto kosto per produkte te ngjashme dhe nga i njeti vend origjine (Spanja), voriojne ne nivelet 200 - 800 Euro. Per kete procedure eshte perlllogaritur nje vlere mesatare transporti prej 400 Euro per dergese e perlllogaritur per 6 furnizime të parashikuara gjate kontrates. Shih Prova 2 - Fatura transporti tokesor produkte lab nga Spanja.

4 Shiko Prova 3 - Proktika e agjencise doganore me importe nga Grifols dhe Kompani te tjera ne fushen diagnostikuese si vlere orientuese, kostoja e llogaritur per 6 furnizime gjate 12 muajve.

5 Ky sherbim do te ofrohet nga inxhinjeri jone z. Andi Balla, me page bruto 186.996 leke, i trajnuor nga disa kompani multinacionale konkretisht / angazhuar me komponite Abbott, Grifols (NAT + IH), Erba Manheim, Alcon, Biomerieux, BD, pro Grifols eshte nje nga 6 llogarite e klienteve te mbajtura prej cy, ne proportion eshte llogaritur edhe kosto perkatese e pages per kete oferte sa 20 % e pages vjetore. Shiko Prova 4 – listepagese e muajit Prill 2022 dhe Prova 5 - Certifikata te inxhinjerit per secilen kompani qe eshte I angazhuar.

6 jane llogaritur gjithashtu kosto telefoni te dedikuara per inxhinierin per kete kontrote (perseri paketa baze me kompanine vodafone te ketij punonjesi eshte 25 EUR ku me pak se 1/5 e ze kompania Grifols). Shiko Prova 7 - Fature telefoni celulare

7 Jane llogaritur gjithashtu vlerat e regjistrimit te prodaktve te cilat do te regjistrohen prane AKBPM-se qe perfshijne aparatet, kartat, reagentet, kalibratoret etj ku secili produkt mban nje kosto regjistrimi prej 500 lekesh. Shif - Prova 8 Fatura regjistrimi per produktet prane AKBPM

Ne menyre analitike dhe te detajuar, analiza e koston paraqitet ne Tabelen 1 ne vijim:

Tabela 1 — Analiza e Kostos

	Kosto Direkte	Kosto Indirekte	Vlerat e produkteve te ofruara EUR		Vlerat ne monedhen LEK (ALL) Kurs 120.54 [Banka e Shqip 26.05.22]	
			%	Vlera (EUR)	%	Vlera (ALL)
F	Kosto e Blerjes Reagente + Antisera + Calibrator + Cntr (TERMAT FCA) (1)		52.1%	X €	52.1%	ALL X
	Shpenzime Aparatesh (2)		43.6%	X €	43.6%	ALL X
	Shpenzime Transporti & Siguracion Magazine (3)		1.1%	X €	1.1%	ALL X
	Shpenzime Doganore + magazinash 6 dergesa (4)		0.2%	X €	0.2%	ALL X
	Shpenzime Agjent Servisi & knoë-hoë (5)		1.8%	X C€	1.8%	ALL X
	Shpenzime Telefoni (6)		0.0%	X €	0.0%	ALL X

	<i>Shpenzime Karburanti Administrative</i>	0.1% X €	0.1% ALL X
	<i>Shpenzime Administrative</i>	0.4% X €	0.4% ALL X
	<i>Shpenzime Qeraje + shpenzime zyre kancelari + shpenzime pastrimit + tjera</i>	0.5% X €	0.5% ALL X
	<i>Shpenzime regjistrim produktesh AKBPM (S)</i>	0.2% X €	0.2% ALL X
	<i>Total shpenzime per Grifols Imunohematologji</i>	100% X €	100% ALL X
	<i>Vlera e ofertuar dhe perqindja e fitimit per Pegasus shpk</i>	17.0% X €	17.0% ALL X

Sic vihet re, nga analiza e detajuar e kostos, jo vetem qe ne arrijme të permbushim furnizimet e kerkuara brenda nivelit te kostove te perlllogaritura, por edhe rezulton nje norme fitimi prej 17 %.

b) Zgjdhjet teknike te perzgjedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve ose sherbimeve ose per kryerjen e punes;

Ne oferten e dorezuar nga shoqeriaa jone ne SPE per kete tender ne daten 20.05.2022, mund te verehet lehtesisht se ne permbushje te pikes 3 te Pikes 2.3 "Kapaciteti teknik", te Shtojces 7 te Dokumentave te Tenderit, ne kemi paraqitur dokurmentacionin qe verteton lidhjen direkte te shoqerise sone me prodhuesin Grifols.

Nga pikepamja e logjikes dhe objektive te biznesit, per shoqerine Pegasus. sh.p.k., kjo procedure ka nje rendesi shume te madhe. Duhet mbajtur parasysh, se QKTGJ, eshte klienti me i madh ne sektorin publik shqiptar per kete grup produktesh.

Duke qene distributor i vetem per Shqiperine qe nga viti 2016, i shoqerise Grifols (nga prodhuesit kryesore te testeve per imunohematologji, NAT testing sikurse dhe prodhuesi me i madh boteror i IVIG, albumin, Factor VIII dhe produkteve te tjera te plazmes), me ne fund, na u dha mundesia te plotesojme kushtet dhe te konkurojme per grupin e produkteve te kesaj procedure.

Ne kontekstin e mesiperem, Pegasus. ne pergatitjen e kesaj oferte, ka pasur jo Vetem qellimin dhe objektivin e jashtezakonshem per te fituar, por edhe mbeshtetje maksimale nga shoqeria prodhuese Grifols, si me planifikimin nga pikepamja teknike e perzgjedhjes se produkteve, ashtu edhe ne oferten financiare, duke qene edhe vete Grifols te interesuar, te shenojne hyrjen per here te pare ne sektorin publik shqiptar me kete kategori produktesh.

Shiko Prova 1 - Email i dates 17/05/2022, me oferten nga z. Franck Le Comet, perfaqesues i Grifols, Menaxher per Evropen Qendrore dhe Lindore, ku shprehet "E kuptoj qe eshte shume kritike qe te hyjme tani ne QKTGJ dhe ne jemi dakord ta mbeshtesim Pegasus me akoma me shume zbritje per Vitin 1, me qellim qe te jete edhe me konkures" dhe me tej referon ne cmimet e

Kolones M ne tabelen bashkelidhur e-mailit me nje vlere totale te ofertes se reagenteve prej 110,810.70 € dhe nje nga pajisjet gjithashtu ofrohet falas.

Per me teper, Kompania Grifols S.A ka ofruar aparatura te gjenerates se fundit plotesisht te reja, te cilat kane nje garanci prej 15 muajsh nga momenti i njoftimit te dergimit te tyre, duke u angazhuar maksimalisht per kete projekt.

Shiko Prova 9 - email i dates 30/07/2022 nga Z. Franck Le Comet.

c) origjinalitetin e furnizimeve te propozuara nga ofertuesi;

Artikujt e ofruar nga Shoqeria jone plotesoje me gjitha specifikimet teknike te kerkuara nga ju ne dokumentat e tenderit, te gjitha standardet nderkombetare te cilesise dhe pa dyshim eshte i padiskutueshem origjinaliteti i produkteve te ofruara, edhe per shkak te marredhenies tashme te konsoliduar tonen me prodhuesin sic sqaruam me siper. Kjo provohet lehtesisht nga dokumentacioni i paraqitur nga ana jone ne SPE, ne permbushje te pikave 2, 3, dhe 5 te Pikes 2.3 "Kapaciteti teknik", te Shtojces 7 te Dokumentave te Tenderit.

ç) pajtueshinerine me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes;

Shoqeria jone ka qene dhe eshte ne vijimesi zbatuese korrekte e normave ligjore e nenligjore te punes, mbrojtjes sociale apo mjedisore. Ne deklarojme dhe paguajme realisht dhe rregullisht punonjesit tane, si dhe sigurojme ne vijimesi kushtet e punes qe kerkohen nga legjislacioni ne fuqi. Kjo provohet lehtesisht nga fakti qe organet tatimore ne vijimesi konfirmojne shlyerjen e rregullt te detyrimeve tatimore dhe ato te sigurimeve shoqerore e shendetesore per stafin tone. Gjithashtu, shoqeria respekton me perpikmeri dhe miremban ne menyre konstante te gjitha standardet e cilesise te aplikueshme ne fushen tone te aktivitetit, standarte pa te cilat do te ishte e pamundur te kishim marredheniet e distribucionit, aq me teper si distributor i vetem i drejtperdrejte, sic treguam me siper.

Duke shpresuar qe sqarimet e mesiperme se bashku me provat e paraqitura nga ana jone jane ezauruese, mbetemi ne pritje te vleresimit perfundimtar te ofertes sone."

Bashkëlidhur shkresës së mësipërme janë dorëzuar gjithashtu:

- Email nga kompania Grifols (franck.lecornet@grifols.com), datë 17.05.2022 ora 07:41, drejtuar Christos Antonis dhe Ç Janis Karathanos, me subjekt "IH tender Shqipëri – Cmimet", bashkëngjitur Testet & Sasitë për IH për 2022 tender në Shqipëri dokumentet pune _17May22, (i përkthyer dhe noterizuar) me përmbajtje "...Sikurse e diskutuam edhe ditën e djeshme, të lutem gjej bashkëngjitur dokumentin e ri me çmimet preferenciale vetëm për vitin e parë. E kuptoj që është teper e rëndesishme të hyjmë në këtë moment në Qendrin Kombetare të Transfuzionit të Gjakut Tiranë dhe ne biem dakort të suportojmë Pegasus me një ekstra ulje për Vitin e Praë në mënyre që të jetë sa më shumë konkurruese. Për sa i përket vitit të dytë 2 (tenderave të ardhshëm) do të aplikohen çmimet fillestare pa ulje. Në dokumentin Excel bashkangjitur, faqja e 3-të, kam shtuar cmimet e reja vetëm për vitin e 1-rë në kolonen M. Prej viti të 2-të (tenderi i 2-te) cmimet e aplikueshme do të jene sipas kolones D/G. [...]. Bashkelidhur tabela me kosto te ofruar nga Kompania Grifols.
- Fatura kosto transporti

- Dokumentacion për punonjësin A.B
- Listepagesa prill 2022
- Fatura shpenzime telefonike
- Garancia nga kompania Grifols, për 15 muaj të çdo aparati

III.8.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:
“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.8.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- *Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*
- *Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.8.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 30.936.080 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Theksojmë faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht

dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjisllacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. **Gjykojmë se, nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, theksoj se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë**

autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.8.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, vlerësojmë, se operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës nr. 0107/22 prot. datë 30.05.2022 me lëndë “Përgjigje për sqarim të ofertës anomalisht të ulët”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimesi ka deklaruar se: “...Shoqëria Pegasus shpk është një ndër operatorët ekonomikë më të mëdhenj që operon në këtë fushë në tregun shqiptar prej më shumë se 25 vjetësh. Si një ndër importuesit dhe distributorët më të mëdhenj në vend, Pegasus shpk ka pasur një rritje të qëndrueshme në këtë biznes, duke demonstruar se ofron për klientët si publikë dhe privatë cilësi maksimale eficientë dhe siguri të padiskutueshme.

Elementët e furnizimit të ofruar nga ana jonë për AK në këtë procedurë janë:

- *Furnizimi për një periudhë 12 mujore i AK me Reagentë dhe aksesore të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, sipas listës së artikujve me specifikimet dhe sasi të përcaktuara në Specifikimet Teknike në Dokumentat e Tenderit (DT).*

- *Dhënia dhe vënia në përdorim për një periudhë 12 mujore e pajisjeve të kërkuara nga AK, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara prej AK në DT.*

Në zbatim të nenit 93 pika 1 dhe 2 të LPP dhe nenit 82 të VKM, i ndryshuar, në vijim të kërkesës suaj, po ju paraqesim argumentin e ofertës sonë në këtë procedurë, e konstatuar si ofertë anomalisht e ulët.

Sic përcakton neni 93 i LPP, në mënyrë të detajuar dhe të shoqëruar me dokumenta provuesm shpjegimet tona do të jepen në lidhje me plotësimin në mënyrë kumulative të kushteve të mëposhtme:

a) *Ana ekonomike e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndertimit;*

Fillimisht duhet të theksojmë se PEGASUS sh.p.k., nuk është prodhues i mallrave të ofruara, por distributor i tyre i drejtperdrejt nga prodhuesi, konkretisht shoqëria Grifols S.A.

Nga pikepamja e ndertimit të ofertes financiare, sqarojmë se në këtë lloj furnizimi, kostot totale janë të kompozuar nga kostot fikse dhe kostot operative.

Kostot indirekte, të cilat janë të pandryshueshme dhe perbehen nga: shpenzime qeraje, kancelari zyre, telefoni & internet, energji, ujë, pastrim, shpenzime karburanti, shpenzime të tjera administrative si noterizime, perkthime etj. Në total këto kategori kostosh perbehen rreth 1 % të kostove totale të ofertes.

Kostot direkte që perbejne pjesen tjetër, janë ngushtesisht të lidhura me furnizimin specifik të ofruar. Me konkretisht, kostot direkte për oferten tona në këtë procedurë janë si vijon:

1. *Kosto e Blerjes Karta + Reagente + Antisera + Calibrator + Cntr. - rreth 52.1 % të kostove totale*

2. *Kostot e blerjes së pajisjeve të kërkuara - rreth 43.6 % të kostove totale*

3. Shpenzime transporti dhe siguracioni ne transport - rreth 1.1 % te kostove totale
4. Shpenzime agjenci dhe magazinimi doganore — rreth 0.2 % te kostove totale
5. Kosto personeli (pike kontakti, suport teknik & knoë hoë) — rreth 1,8 % e kostove totale
6. Shpenzime Regjistrimi pranë agjencisë AKBPM – rreth 0.2 % e kostove totale

1 Termat e levrimit nga Grifols jam Free Carrier (FCA), pra nga kostot e transportit nga vendi i origjines (Spanja) dhe te siguracionit perkates, jane te shoqërisë Pegasus në cilesinë e blerësit.

2 Furnitori Grifols, eshte angazhuar qe nje ngo pajisjet (Erytra) ta ofroje pa kosto (me vlere o). Shiko Prova 1 - “Oferta e Grifols per Pegasus date 17/05/2022

3 Produktet ne fjale transportohen nepermjet tokes. Keto kosto per produkte te ngjashme dhe nga i njeti vend origjine (Spanja), voriojne ne nivelet 200 - 800 Euro. Per kete procedure eshte perlllogaritur nje vlere mesatare transporti prej 400 Euro per dergese e perlllogaritur per 6 furnizime të parashikuara gjate kontrates. Shih Prova 2 - Fatura tronsporti tokesor produkte lab nga Spanja.

4 Shiko Prova 3 - Proktika e agjencise doganore me importe nga Grifols dhe Kompani te tjera ne fushen diagnostikuese si vlere orientuese, kostoja e llogaritur per 6 furnizime gjate 12 muajve.

5 Ky sherbim do te ofrohet nga inxhinjeri jone z. Andi Balla, me page bruto 186.996 leke, i trajnuor nga disa kompani multinacionale konkretisht / angazhuar me komponente Abbott, Grifols (NAT + IH), Erba Manheim, Alcon, Biomerieux, BD, pro Grifols eshte nje nga 6 llogarite e klienteve te mbajtura prej cy, ne proportion eshte llogoritur edhe kosto perkatese e pages per kete oferte sa 20 % e pages vjetore. Shiko Prova 4 – listepagese e muajit Prill 2022 dhe Prova 5 - Certifikata te inxhinjerit per secilen kompani qe eshte I angazhuar.

6 jane llogaritur gjithashtu kosto telefoni te dedikuara per inxhinierin per kete kontrote (perseri paketa baze me kompanine vodafone te ketij punonjesi eshte 25 EUR ku me pak se 1/5 e ze kompania Grifols). Shiko Prova 7 - Fature telefoni celulare

7 Jane llogaritur gjithashtu vlerat e regjistrimit te prodaktve te cilat do te regjistrohen prane AKBPM-se qe perfhijne aparatet, kartat, reagentet, kalibratoret etj ku secili produkt mban nje kosto regjistrimi prej 500 lekesh. Shif - Prova 8 Fatura regjistrimi per produktet prane AKBPM Ne menyre analitike dhe te detajuar, analiza e kosos paraqitet ne Tabelen 1 ne vijim: “... Përveç kësaj, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK në mbështetje të deklarimeve më sipër, ka paraqitur Analizë kosos, si më poshtë:

F	Kosto Direkte	Kosto Indirekte	Vlerat e produkteve te ofruara EUR	Vlerat ne monedhen LEK (ALL) Kurs 120.54 [Banka e Shqip 26.05.22]
			% Vlora (EUR)	% Vlora (ALL)
	Kosto e Blerjes Reagente + Antisera + Calibrator + Cntr (TERMAT FCA) (1)		52.1% X€	52.1% X ALL
	Shpenzime Aparatesh (2)		43.6% X €	43.6% X ALL
	Shpenzime Transporti & Siguracion Magazine (3)		1.1% X €	1.1% X ALL

<i>Shpenzime Doganore + magazinash 6 dergesa (4)</i>		0.2% X €	0.2% X ALL
<i>Shpenzime Agjent Servisi & knoë-hoë (5)</i>		1.8% X C€	1.8% X ALL
<i>Shpenzime Telefoni (6)</i>		0.0% X €	0.0% X ALL
	<i>Shpenzime Karburanti Administrative</i>	0.1% X €	0.1% X ALL
	<i>Shpenzime Administrative</i>	0.4% X €	0.4% X ALL
	<i>Shpenzime Qeraje + shpenzime zyre kancelari + shpenzime pastrimii + tjera</i>	0.5% X €	0.5% X ALL
<i>Shpenzime regjistrim produktesh AKBPM (S)</i>		0.2 % X €	0.2% X ALL
<i>Total shpenzime per Grifols Imunohematologji</i>		100% X €	100% X ALL
<i>Vlera e ofertuar dhe perqindja e fitimit per Pegasus shpk</i>		17.0% X €	17.0% X ALL

Sic vihet re, nga analiza e detajuar e kostos, jo vetem qe ne arrijme të permbushim furnizimet e kerkuara brenda nivelit te kostove te perllogaritura, por edhe rezulton nje norme fitimi prej 17 %.

c) Zgjidhjet teknike te perzgjedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve ose sherbimeve ose per kryerjen e punes;

Ne oferten e dorezuar nga shoqeriaa jone ne SPE per kete tender ne daten 20.05.2022, mund te verehet lehtesisht se ne permbushje te pikes 3 te Pikes 2.3 "Kapaciteti teknik", te Shtojces 7 te Dokumentave te Tenderit, ne kemi paraqitur dokurnentacionin qe verteton lidhjen direkte te shoqerise sone me prodhuesin Grifols.

Nga pikepamja e logjikes dhe objektive te biznesit, per shoqerine Pegasus. sh.p.k., kjo procedure ka nje rendesi shume te madhe. Duhet mbajtur parasysh, se QKTGJ, eshte klienti me i madh ne sektorin publik shqiptar per kete grup produktesh.

Duke qene distributor i vetem per Shqiperine qe nga viti 2016, i shoqerise Grifols (nga prodhuesit kryesore te testeve per imunohematologji, NAT testing sikurse dhe prodhuesi me i madh boteror i IVIG, albumin, Factor VIII dhe produkteve te tjera te plazmes), me ne fund, na u dha mundesia te plotesojmë kushtet dhe te konkurojmë per grupin e produkteve te kesaj procedure.

Ne kontekstin e mesiperm, Pegasus. ne pergatitjen e kesaj oferte, ka pasur jo Vetem qellimin dhe objektivin e jashtezakonshem per te fituar, por edhe mbeshtetje maksimale nga shoqeria prodhuese Grifols, si me planifikimin nga pikepamja teknike e perzgjedhjes se produkteve, ashtu edhe ne oferten financiare, duke qene edhe vete Grifols te interesuar, te shenojne hyrjen per here te pare ne sektorin publik shqiptar me kete kategori produktesh.

Shiko Prova 1 - Email i dates 17/05/2022, me oferten nga z. Franck Le Comet, perfaqesues i Grifols, Menaxher per Evropen Qendrore dhe Lindore, ku shprehet "E kuptoj qe eshte shume kritike qe te hyjme tani ne QKTGJ dhe ne jemi dakord ta mbeshtesim Pegasus me akoma me shume zbritje per Vitin 1, me qellim qe te jete edhe me konkures" dhe me tej referon ne cmimet e Kolones M ne tabelen bashkelidhur e-mailit me nje vlere totale te ofertes se reagenteve prej 110,810.70 € dhe nje nga pajisjet gjithashtu ofrohet falas.

Per me teper, Kompania Grifols S.A ka ofruar aparatura te gjenerates se fundit plotesisht te reja, te cilat kane nje garanci prej 15 muajsh nga momenti i njoftimit te dergimit te tyre, duke u angazhuar maksimalisht per kete projekt.

Shiko Prova 9 - email i dates 30/07/2022 nga Z. Franck Le Comet.

c) origjinalitetin e furnizimeve te propozuara nga ofertuesi;

Artikujt e ofruar nga Shoqeria jone plotesoje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara nga ju ne dokumentat e tenderit, te gjitha standardet nderkombetare te cilesise dhe pa dyshim eshte i padiskutueshem origjinaliteti i produkteve te ofruara, edhe per shkak te marredhenies tashme te konsoliduar tonen me prodhuesin sic sqaruam me siper. Kjo provohet lehtesisht nga dokumentacioni i paraqitur nga ana jone ne SPE, ne permbushje te pikave 2, 3, dhe 5 te Pikes 2.3 "Kapaciteti teknik", te Shtojces 7 te Dokumentave te Tenderit.

ç) pajtueshinerine me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes;

Shoqeria jone ka qene dhe eshte ne vijimesi zbatuese korrekte e normave ligjore e nenligjore te punes, mbrojtjes sociale apo mjedisore. Ne deklarojme dhe paguajme realisht dhe rregullisht punonjesit tane, si dhe sigurojme ne vijimesi kushtet e punes qe kerkohen nga legjislacioni ne fuqi. Kjo provohet lehtesisht nga fakti qe organet tatimore ne vijimesi konfirmojne shlyerjen e rregullt te detyrimeve tatimore dhe ato te sigurimeve shoqerore e shendetesore per stafin tone.

Gjithashtu, shoqeria respekton me perpikmeri dhe miremban ne menyre konstante te gjitha standardet e cilesise te aplikueshme ne fushen tone te aktivitetit, standarte pa te cilat do te ishte e pamundur te kishim marredheniet e distribucionit, aq me teper si distributor i vetem i drejtperdrejte, sic treguam me siper.

Duke shpresuar qe sqarimet e mesiperme se bashku me provat e paraqitura nga ana jone jane ezauruese, mbetemi ne pritje te vleresimit perfundimtar te ofertes sone."

Bashkëlidhur shkresës së mësipërme operatori ekonomik "Pegasus" SHPK, ka dorëzuar gjithashtu: Email nga kompania Grifols për ofrimin e çmimeve favorizuese për vitin e parë për operatorin ekonomik "Pegasus" SHPK, për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ku bashkëlidhur email-it është paraqitur gjithashtu tabela me kostot e produkteve të ofruar nga Kompania Grifols. Gjithashtu, operatori ekonomik "Pegasus" SHPK bashkëlidhur infomacionit të mësipërm ka dorëzuar Fatura kosto transporti, Dokumentacion për punonjësën A.B, Listëpagesa prill 2022, Fatura shpenzime telefonike, Garancia nga kompania Grifols, për 15 muaj të çdo aparati.

III.8.7. Sa më sipër, gjykojmë se, operatori ekonomik "Pegasus" SHPK në rastin konkret ka arritur nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, të argumentojë të gjitha elementet e ofertës së tij. Përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon, të tilla si çmimet favorizuese nga kompania prodhuese Grifols për vitin e parë, por edhe duke argumentuar të gjitha shpenzimet e tjera indirekte duke i

pasqyruar në analizën e kostos së tij. Subjekti “Pegasus” SHPK ka paraqitur edhe analizën e detajuar të kostos në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomikë të **metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjithë elementët.**

Në rastin konkret, gjykoj, se nga ana e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK janë dorëzuar të gjitha dokumentat provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Lasermed” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-25594-04-19-2022, me objekt: Loti 1 “Karta, reagentë dhe aksesori të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë ne QKTGJ dhe Bankat e gjakut në Tirane perfshire venien e pajisjeve ne perdorim”, me fond limit 59.233.237 lekë pa Tvsh, zhvilluar me datë 20.05.2022 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut Tiranë.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Lasermed” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK, dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Lasermed” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Kreshnik Ternova (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe dispozitivit të tij, përse i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Lasermed” SHPK, konkretisht nuk jam dakord me arsyetimin në pikën III.4 e në vijim, III.5 e në vijim dhe III.8, si dhe pikën 2 të dispozitivit të vendimit për sa i përket çështjes me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-25594-04-19-2022, me objekt: Loti 1 “*Karta, reagentë dhe aksesore të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë ne QKTGJ dhe Bankat e gjakut në Tirane përfshire venien e pajisjeve ne perdorim*”, me fond limit 59.233.237 lekë pa Tvsh, zhvilluar me datë 20.05.2022 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut Tiranë.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

I.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Laser Med” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK me argumentin se “*Operatori ekonomik Pegasus shpk nuk përmbush kriteret e vecanta për kualifikim pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 3) ne shtojcen perkatese eshte kerkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA ose deklarate konformiteti CE ose FDA (Aty ku eshte e aplikueshme)*”

sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre (Dokumentat duhet të jene të perkthyer dhe të noterizuara).

Duke qene se Laser Med shpk ka nje eksperience te konsiderueshme ne trajtimin e artikujve/ mallrave objekt te prokurimit dhe, per rrjedhoje, eshte e informuar per kompanite prodhues te tyre, gamen e prodhimit dhe specifikimet teknike te tyre, insiston se jo per te gjithë artikujt ofertuesi ka paraqitur Certifikata konformiteti CE ose FDA, si dhe deklaratat e konformitetit qe mund te kete paraqitur ky operator ekonomik nuk perfshijne te gjithë artikujt qe mund te aplikohen.”, vërej se:

I.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veccanta të kualifikimit”, për Lotin 1, në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

5. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA ose deklarate konformiteti CE ose FDA (Aty ku eshte e aplikueshme) sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre (Dokumentat duhet të jene të perkthyer dhe të noterizuara).*

I.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- EC Declaration of Conformity Hematies Reactivo - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210349, i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity Tarjetas DG Gel/DG Gel Cards - me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 213659; 210350; 210353; 210126; 210198; i përkthyer dhe i noterizuar;
- EC Declaration of Conformity DG Gel Neutral 210320/210343- me prodhues “Diagnostic Grifols” S.A për produktet me kod të markuar 210343; i përkthyer dhe i noterizuar;
specialisti/ eksperti sipas fushës së ekspertizës përkatëse, i cili nuk ishte përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit R.Gj) dhe tre anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik dhe inspektori i ceështjes. Specialisti/ eksperti i fushës së ekspertizës përkatëse, i cili nuk ishte përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit me inicialet R.Gj është thirrur në kundërshkrim të plotë të, rregullore **“Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”** Nr 1883 prot datë 05.10.2021 nenit 24 pika 1, *“Nëse gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës Komisioni vlerëson, se për sqarimin e fakteve kërkohen njohuri të posqme në fushat e shkencës, teknikës, teknologjisë ose artit, Komisioni mund të urdhërojë marrjen e mendimit të ekspertëve ose kryerjen e ekspertizës në laboratorët të specializuar”* dhe nenit 24 pika 2 Ekspertët perzgjidhen nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar... në rastin konkret shtetasi R. Gj nuk është pjesë e ekspertëve në listën e miratuar nga KPP, gjithashtu nuk ka dhënë prova të dokumentuara që ka titullin ekspert në fushën e objektit të prokurimit pra cdo interpretim teknik i ketij te fundit eshte **nul** . Pra menyra e perzgjedhjes si opinionist e shtetases R.Gj eshte e gabuar. Lidhur me deklaratat e dhena nga përfaqesuesit e autoriteti kontraktor në cilësinë e një specialist i fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave znj. I.S, Ka mbajtur te njejtin qendrim me vendimin e komisionit te vleresimit te ofertave, pra opinioni i saj ngre dyshime qe nuk jane objektive por subjektiv per artikullin nr 8. Shtetasja I.S ne perfundim nuk shprehet per munges te mospermbushjes se artikullit Nr 8 nga dokumentat e ngarkuara ne SPE, por e mbron vendimin e KVO duke parashtruar mundesine e permbushjes se kriterit me kartat e artikujve te tjere çka sjell devijim te permbushjes se kriterit.

Nga verifikimi i dokumentacionit ngarkuar ne SPE nga operatori ekonomik Pegasus Shpk, konstatojë se, specifikimet teknike të artikullit 8, nuk gjejnë të dokumentuar në kataloget e dorëzuar nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, duke mos plotësuar kështu kërkesat e autoritetit kontraktor.

Gjykoj se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sqarojë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, i ndryshuar, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik Laser Med shpk ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK qëndrojnë.

I.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Lasermed” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsytimin se *“Gjithashtu operatori ekonomik Pegasus shpk, me vleren me te ulet nuk permbush kerkesat e nenit 93, të LPP-së per oferte anomalisht te ulet, pasi*

dokumentacioni analize kosto e paraqitur prej tij nuk justifikon ofertën e tij anomalisht të ulët sipas përcaktimeve të bera në nenin 93 të LPP.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

I.3.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. 167/23 prot., datë 01.07.2022, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “Pegasus” SHPK **është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët**. Në këto kushte në shkresën e mësipërme, autoriteti kontraktor deklaroi se *“Në zbatim të nenit 93, në datë 26.05.2022, nëpërmjet SPE, iu kërkua ofertuesit Pegasus të paraqesë shpjegimet me shkrim brenda 3 ditë pune, për të argumentuar ofertën anomalisht të ulët”*.

I.3.2. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se, në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor, më datë 30.05.2022 operatori ekonomik “Pegasus” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur në mënyrë shkresore dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresë nr. 0107/22 prot., datë 30.05.2022, me objekt: *“Përgjigje për sqarim të ofertës anomalisht të ulët”*, protokolluar në autoritetin kontraktor me nr. 167/7 prot., datë 30.05.2022.

Në këtë shkresë, ndër të tjera, citohet se: *“[...]Shoqëria Pegasus shpk është një ndër operatorët ekonomikë më të mëdhenj që operon në këtë fushë në tregun shqiptar prej më shumë se 25 vjetësh. Si një ndër importuesit dhe distributorët më të mëdhenj në vend, Pegasus shpk ka pasur një rritje të qëndrueshme në këtë biznes, duke demonstruar se ofron për klientët si publikë dhe privatë cilësi maksimale eficientë dhe siguri të padiskutueshme.*

Elementët e furnizimit të ofruar nga ana jonë për AK në këtë procedurë janë:

- *Furnizimi për një periudhë 12 mujore i AK me Reagentë dhe aksesore të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, sipas listës së artikujve me specifikimet dhe sasinë e përcaktuara në Specifikimet Teknike në Dokumentat e Tenderit (DT).*
- *Dhënia dhe vënia në përdorim për një periudhë 12 mujore e pajisjeve të kërkuara nga AK, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara prej AK në DT.*

Në zbatim të nenit 93 pika 1 dhe 2 të LPP dhe nenit 82 të VKM, i ndryshuar, në vijim të kërkesës suaj, po ju paraqesim argumentin e ofertës sonë në këtë procedurë, e konstatuar si ofertë anomalisht e ulët.

Sic përcakton neni 93 i LPP, në mënyrë të detajuar dhe të shoqëruar me dokumenta provuesm shpjegimet tona do të jepen në lidhje me plotësimin në mënyrë kumulative të kushteve të mëposhtme:

d) Ana ekonomike e procesit te prodhimit, te sherbimeve te ofruara ose të metodes se ndertimit;

Fillimisht duhet te theksojme se PEGASUS. sh.p.k., nuk eshte prodhues i mallrave te ofruara, por distributor i tyre i drejtperdrejt nga prodhuesi, konkretisht shoqeria Grifols S.A.

Nga pikepamja e ndertimit te ofertes financiare, sqarojme se ne kete lloj furnizimi, kostot totale jane te kompozuara nga kostot fikse dhe kostot operative.

Kostot indirekte, te cilat jane te pandryshueshme dhe perbehen nga: shpenzime qeraje, kancelari zyre, telefoni & internet, energji, uje, pastrim, shpenzime karburanti, shpenzime te tjera administrative si noterizime, perkthime etj. Ne total kjo kategori kostosh perben rreth 1 % te kostove totale te olertes.

Kostot direkte qe perbejne pjesen tjeter, jane ngushtesisht te lidhura me furnizimin specifik te ofruar. Me konkretisht, kostot direkte per oferten tone ne kete procedure jane si vijon:

7. Kosto e Blerjes Karta + Reagente + Antisera + Calibrator + Cntr. - rreth 52.1 % te kostove totale
8. Kostot e blerjes se pajisjeve te kerkuara - rreth 43.6 % te kostove totale
9. Shpenzime transporti dhe siguracioni ne transport - rreth 1.1 % te kostove totale
10. Shpenzime agjenci dhe magazinimi doganore — rreth 0.2 % te kostove totale
11. Kosto personeli (pike kontakti, suport teknik & knoë hoë) — rreth 1,8 % e kostove totale
12. Shpenzime Regjistrimi pranë agjencisë AKBPM – rreth 0.2 % e kostove totale

1 Termat e levrimit nga Grifols jam Free Carrier (FCA), pra nga kostot e transportit nga vendi i origjines (Spanja) dhe te siguracionit perkates, jane te shoqërisë Pegasus në cilesinë e blerësit.

2 Furnitori Grifols, eshte angazhuar qe nje ngo pajisjet (Erytra) ta ofroje pa kosto (me vlere o). Shiko Prova 1 - "Oferta e Grifols per Pegasus date 17/05/2022

3 Produktet ne fjale transportohen nepermjet tokes. Keto kosto per produkte te ngjashme dhe nga i njeti vend origjine (Spanja), voriojne ne nivelet 200 - 800 Euro. Per kete procedure eshte perlllogaritur nje vlere mesatare transporti prej 400 Euro per dergese e perlllogaritur per 6 furnizime të parashikuara gjate kontrates. Shih Prova 2 - Fatura tronsporti tokesor produkte lab nga Spanja.

4 Shiko Prova 3 - Proktika e agjencise doganore me importe nga Grifols dhe Kompani te tjera ne fushen diagnostikuese si vlere orientuese, kostoja e llogaritur per 6 furnizime gjate 12 muajve.

5 Ky sherbim do te ofrohet nga inxhinjeri jone z. Andi Balla, me page bruto 186.996 leke, i trajnuor nga disa kompani multinacionale konkretisht / angazhuar me komponite Abbott, Grifols

(NAT + IH), Erba Mannheim, Alcon, Biomerieux, BD, pro Grifols eshte nje nga 6 llogarite e klienteve te mbajtura prej cy, ne proportion eshte llogoritur edhe kosto perkatese e pages per kete oferte sa 20 % e pages vjetore. Shiko Prova 4 – listepagese e muajit Prill 2022 dhe Prova 5 - Certifikata te inxhinjerit per secilen kompani qe eshte I angazhuar.

6 jane llogaritur gjithashtu kosto telefoni te dedikuara per inxhinierin per kete kontrote (perseri paketa baze me kompanine vodafone te ketij punonjesi eshte 25 EUR ku me pak se 1/5 e ze kompania Grifols). Shiko Prova 7 - Fature telefoni celulare

7 Jane llogaritur gjithashtu vlerat e regjistrimit te prodaktve te cilat do te regjistrohen prane AKBPM-se qe perfshijne aparatet, kartat, reagentet, kalibratoret etj ku secili produkt mban nje kosto regjistrimi prej 500 lekesh. Shif - Prova 8 Fatura regjistrimi per produktet prane AKBPM

Ne menyre analitike dhe te detajuar, analiza e kostos paraqitet ne Tabelen 1 ne vijim:

	Kosto Direkte	Kosto Indirekte	Vlerat e produkteve te ofruara EUR	Vlerat ne monedhen LEK (ALL) Kurs 120.54 [Banka e Shqip 26.05.22]	
			% Vlera (EUR)	% Vlera (ALL)	
Elementete K koston	Kosto e Blerjes Reagente + Antisera + Calibrator + Cntr (TERMAT FCA) (1)		52.1% X €	ALL 52.1% X	
	Shpenzime Aparatesh (2)		43.6% X €	ALL 43.6% X	
	Shpenzime Transporti & Siguracion Magazine (3)		1.1 % X €	ALL 1.1% X	
	Shpenzime Doganore + magazinash 6 dergesa (4)		0.2% X €	ALL 0.2% X	
	Shpenzime Agjent Servisi & knoë-hoë (5)		1.8% X €	ALL 1.8% X	
	Shpenzime Telefoni (6)		0.0% X €	ALL 0.0% X	
		Shpenzime Karburanti Administrative		0.1% X €	ALL 0.1% X
		Shpenzime Administrative		0.4% X €	ALL 0.4% X
		Shpenzime Qeraje + shpenzime zyre kancelari + shpenzime pastrimii + tjera		0.5% X €	ALL 0.5% X

Shpenzime regjistrim produktesh AKBPM (S)		0.2 % X €	0.2% X	ALL
Total shpenzime per Grifols Imunohematologji		100% X €	100% X	ALL
Vlera e ofertuar dhe perqindja e fitimit per Pegasus shpk		17.0% X €	17.0% X	ALL

bela 1 — Analiza e Kostos

Sic vihet re, nga analiza e detajuar e kostos, jo vetem qe ne arrijme të permbushim furnizimet e kerkuara brenda nivelit te kostove te perlllogaritura, por edhe rezulton nje norme fitimi prej 17 %.

- e) Zgjidhjet teknike te perzgjedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve ose sherbimeve ose per kryerjen e punes;

Ne oferten e dorezuar nga shoqeriaa jone ne SPE per kete tender ne daten 20.05.2022, mund te verehet lehtesisht se ne permbushje te pikes 3 te Pikes 2.3 "Kapaciteti teknik", te Shtojces 7 te Dokumentave te Tenderit, ne kemi paraqitur dokurmentacionin qe verteton lidhjen direkte te shoqerise sone me prodhuesin Grifols.

Nga pikepamja e logjikes dhe objektive te biznesit, per shoqerine Pegasus. sh.p.k., kjo procedure ka nje rendesi shume te madhe. Duhet mbajtur parasysh, se QKTGJ, eshte klienti me i madh ne sektorin publik shqiptar per kete grup produktesh.

Duke qene distributor i vetem per Shqiperine qe nga viti 2016, i shoqerise Grifols (nga prodhuesit kryesore te testeve per imunohematologji, NAT testing sikurse dhe prodhuesi me i madh boteror i IVIG, albumin, Factor VIII dhe produkteve te tjera te plazmes), me ne fund, na u dha mundesia te plotesojmë kushtet dhe te konkurojmë per grupin e produkteve te kesaj procedure.

Ne kontekstin e mesiperm, Pegasus. ne pergatitjen e kesaj oferte, ka pasur jo Vetem qellimin dhe objektivin e jashtezakonshem per te fituar, por edhe mbeshtetje maksimale nga shoqeria prodhuese Grifols, si me planifikimin nga pikepamja teknike e perzgjedhjes se produkteve, ashtu edhe ne oferten financiare, duke qene edhe vete Grifols te interesuar, te shenojne hyrjen per here te pare ne sektorin publik shqiptar me kete kategori produktesh.

Shiko Prova 1 - Email i dates 17/05/2022, me oferten nga z. Franck Le Comet, perfaqesues i Grifols, Menaxher per Evroperen Qendrore dhe Lindore, ku shprehet "E kuptoj qe eshte shume kritike qe te hyjme tani ne QKTGJ dhe ne jemi dakord ta mbeshtesim Pegasus me akoma me shume zbritje per Vitin 1, me qellim qe te jete edhe me konkures" dhe me tej referon ne cmimet e Kolones M ne tabelen bashkelidhur e-mailit me nje vlere totale te ofertes se reagenteve prej 110,810.70 € dhe nje nga pajisjet gjithashtu ofrohet falas.

Per me teper, Kompania Grifols S.A ka ofruar aparatura te gjenerates se fundit plotesisht te reja, te cilat kane nje garanci prej 15 muajsh nga momenti i njoftimit te dergimit te tyre, duke u angazhuar maksimalisht per kete projekt.

Shiko Prova 9 - email i dates 30/07/2022 nga Z. Franck Le Comet.

c) originalitetin e furnizimeve te propozuara nga ofertuesi;

Artikujt e ofruar nga Shoqeria jone plotesoje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara nga ju ne dokumentat e tenderit, te gjitha standardet nderkombetare te cilesise dhe pa dyshim eshte i padiskutueshem origjinaliteti i produkteve te ofruara, edhe per shkak te marredhenies tashme te konsoliduar tonen me prodhuesin sic sqaruam me siper. Kjo provohet lehtesisht nga dokumentacioni i paraqitur nga ana jone ne SPE, ne permbushje te pikave 2, 3, dhe 5 te Pikes 2.3 "Kapaciteti teknik", te Shtojces 7 te Dokumentave te Tenderit.

cc) pajtueshinerine me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes;

Shoqeria jone ka qene dhe eshte ne vijimesi zbatuese korrekte e normave ligjore e nenligjore te punes, mbrojtjes sociale apo mjedisore. Ne deklarojme dhe paguajme realisht dhe rregullisht punonjesit tane, si dhe sigurojme ne vijimesi kushtet e punes qe kerkohen nga legjislacioni ne fuqi. Kjo provohet lehtesisht nga fakti qe organet tatimore ne vijimesi konfirmojne shlyerjen e rregullt te detyrimeve tatimore dhe ato te sigurimeve shoqerore e shendetesore per stafin tone.

Gjithashtu, shoqeria respekton me perpikmeri dhe miremban ne menyre konstante te gjitha standardet e cilesise te aplikueshme ne fushen tone te aktivitetit, standarte pa te cilat do te ishte e pamundur te kishim marredheniet e distribucionit, aq me teper si distributor i vetem i drejtperdrejte, sic treguam me siper.

Duke shpresuar qe sqarimet e mesiperme se bashku me provat e paraqitura nga ana jone jane ezauruese, mbetemi ne pritje te vleresimit perfundimtar te ofertes sone."

Bashkëlidhur shkresës së mësipërme janë dorëzuar gjithashtu:

- Email nga kompania Grifols (franck.lecornet@grifols.com), datë 17.05.2022 ora 07:41, drejtuar Christos Antonis dhe CC Janis Karathanos, me subjekt "IH tender Shqipëri – Cmimet", bashkëngjitur Testet & Sasitë për IH për 2022 tender në Shqipëri dokumentet pune _17May22, (i përkthyer dhe noterizuar) me përmbajtje "...Sikurse e diskutuam edhe ditën e djeshme, të lutem gjej bashkëngjitur dokumentin e ri me ccmimet preferenciale vetëm për vitin e parë. E kuptoj që eshte teper e rendesishme të hyjmë në këtë moment në Qendrin Kombetare të Transfuzionit të Gjakut Tiranë dhe ne biem dakort të suportojmë Pegasus me një ekstra ulje për Vitin e Praë në mënyre që të jetë sa më shumë

konkurrese. Për sa i përket vitit të dytë 2 (tenderave të ardhshëm) do të aplikohen ccmimet fillestare pa ulje. Në dokumentin Excel bashkangjitur, faqja e 3-të, kam shtuar cmimet e reja vetëm për vitin e 1-rë në kolonen M. Prej viti të 2-të (tenderi i 2-te) cmimet e aplikueshme do të jene sipas kolones D/G. [...]. Bashkelidhur tabela me kosto të ofruar nga Kompania Grifols.

- Fatura kosto transporti
- Dokumentacion për punonjës të A.B
- Listepagesa prill 2022
- Fatura shpenzime telefonike
- Garancia nga kompania Grifols, për 15 muaj të cdo aparati

I.3.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...].”

I.3.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

I.3.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 30.936.080 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, **rezulton anomalisht e ulët**. Theksojmë faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në

fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Gjykojë, se nga interpretimi logjik dhe funksional i normës së mësipërme lidhet drejtpërdrejtë me mos realizimit të objektit të prokurimit që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. Gjykoj, se risku që shfaqet në rastin e një oferte anomalisht e ulët është në disa drejtime, si: rreziku për moskryerjen e shërbimit, punime në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, theksoj se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; *“Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”*. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues, gjykoj vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

I.3.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës nr. 0107/22 prot. datë 30.05.2022 me lëndë “Përgjigje për sqarim të ofertës anomalisht të ulët”, ku ka shpjeguar elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimuesi ka deklaruar se: *“...Shoqëria Pegasus shpk është një ndër operatorët ekonomikë më të mëdhenj që operon në këtë fushë në tregun shqiptar prej më shumë se 25 vjetësh. Si një ndër importuesit dhe distributorët më të mëdhenj në vend, Pegasus shpk ka pasur një rritje të qëndrueshme në këtë biznes, duke demonstruar se ofron për klientët si publikë dhe privatë cilësi maksimale eficientë dhe siguri të padiskutueshme.*

Elementët e furnizimit të ofruar nga ana jonë për AK në këtë procedurë janë:

- Furnizimi për një periudhë 12 mujore i AK me Reagentë dhe aksesore të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, sipas listës së artikujve me specifikimet dhe sasi të përcaktuara në Specifikimet Teknike në Dokumentat e Tenderit (DT).

- Dhënia dhe vënia në përdorim për një periudhë 12 mujore e pajisjeve të kërkuara nga AK, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara prej AK në DT.

Në zbatim të nenit 93 pika 1 dhe 2 të LPP dhe nenit 82 të VKM, i ndryshuar, në vijim të kërkesës suaj, po ju paraqesim argumentin e ofertës sonë në këtë procedurë, e konstatuar si ofertë anomalisht e ulët.

Sic përcakton neni 93 i LPP, në mënyrë të detajuar dhe të shoqëruar me dokumenta provuesm shpjegimet tona do të jepen në lidhje me plotësimin në mënyrë kumulative të kushteve të mëposhtme:

a) Ana ekonomike e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndertimit;

Fillimisht duhet të theksojmë se PEGASUS. sh.p.k., nuk është prodhues i mallrave të ofruara, por distributor i tyre i drejtperdrejt nga prodhuesi, konkretisht shoqëria Grifols S.A.

Nga pikepamja e ndertimit të ofertës financiare, sqarojmë se në këtë lloj furnizimi, kostot totale janë të kompozuar nga kostot fikse dhe kostot operative.

Kostot indirekte, të cilat janë të pandryshueshme dhe përbehen nga: shpenzime qeraje, kancelari zyre, telefoni & internet, energji, ujë, pastrim, shpenzime karburanti, shpenzime të tjera administrative si noterizime, perkthime etj. Në total kjo kategori kostosh përbehet rreth 1 % të kostove totale të ofertës.

Kostot direkte që përbejnë pjesën tjetër, janë ngushtesisht të lidhura me furnizimin specifik të ofruar. Në konkretisht, kostot direkte për ofertën tona në këtë procedurë janë si vijon:

1. Kosto e Blerjes Karta + Reagente + Antisera + Calibrator + Cntr. - rreth 52.1 % të kostove totale
2. Kostot e blerjes së pajisjeve të kërkuara - rreth 43.6 % të kostove totale
3. Shpenzime transporti dhe siguracioni në transport - rreth 1.1 % të kostove totale
4. Shpenzime agjenci dhe magazinimi doganore — rreth 0.2 % të kostove totale
5. Kosto personeli (pikë kontakti, suport teknik & këndim) — rreth 1,8 % të kostove totale
6. Shpenzime Regjistrimi pranë agjencisë AKBPM – rreth 0.2 % të kostove totale

1 Termat e levrimit nga Grifols janë Free Carrier (FCA), pra nga kostot e transportit nga vendi i origjines (Sponja) dhe të siguracionit përkatës, janë të shoqëruar me Pegasus në cilesinë e blerësit.

2 Furnitori Grifols, është angazhuar që një nga pajisjet (Erytra) ta ofrojë pa kosto (me vlerë 0). Shiko Prova 1 - “Oferta e Grifols për Pegasus date 17/05/2022

3 Produktet në fjalë transportohen nëpërmjet tokës. Këto kosto për produkte të ngjashme dhe nga i njëti vend origjine (Spanja), variojnë në nivelet 200 - 800 Euro. Për këtë procedurë është përlllogaritur një vlerë mesatare transporti prej 400 Euro për dërgesë e përlllogaritur për 6 furnizime të parashikuara gjatë kontratës. Shih Prova 2 - Fatura transporti tokësor produkte lab nga Spanja.

4 Shiko Prova 3 - Proktika e agjencisë doganore me importe nga Grifols dhe Kompani të tjera në fushën diagnostikuese si vlerë orientuese, kostoja e llogaritur për 6 furnizime gjatë 12 muajve.

5 Ky shërbim do të ofrohet nga inxhinjeri jone z. Andi Balla, me page bruto 186.996 leke, i trajnuor nga disa kompani multinacionale konkretisht / angazhuar me kompanitë Abbott, Grifols (NAT + IH), Erba Mannheim, Alcon, Biomerieux, BD, për Grifols është një nga 6 llogaritë e klienteve të mbajtura prej tyre, në proporcion është llogaritur edhe kosto përkatëse e pages për këtë ofertë sa 20 % e pages vjetore. Shiko Prova 4 – listepagese e muajit Prill 2022 dhe Prova 5 - Certifikata të inxhinjerit për secilën kompani që është i angazhuar.

6 janë llogaritur gjithashtu kosto telefoni të dedikuara për inxhinierin për këtë kontroll (përseri paketa bazë me kompaninë Vodafone të këtij punonjësi është 25 EUR ku me pak se 1/5 e të kompania Grifols). Shiko Prova 7 - Fatura telefoni celulare

7 janë llogaritur gjithashtu vlerat e regjistrimit të prodaktve të cilat do të regjistrohen pranë AKBPM-së që përfshijnë aparatet, kartat, reagentet, kalibratoret etj ku secili produkt mban një kosto regjistrimi prej 500 lekesh. Shif - Prova 8 Fatura regjistrimi për produktet pranë AKBPM Në mënyrë analitike dhe të detajuar, analiza e koston paraqitet në Tabelën 1 në vijim: “... Përveç kësaj, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK në mbështetje të deklarimeve më sipër, ka paraqitur Analizë koston, si më poshtë:

F	Kosto Direkte	Kosto Indirekte	Vlerat e produkteve të ofruara EUR	Vlerat në monedhën LEK (ALL) Kurs 120.54 [Banka e Shqip 26.05.22]
			% Vlera (EUR)	% Vlera (ALL)
	Kosto e Blerjes Reagente + Antisera + Calibrator + Cntr (TERMAT FCA) (1)		52.1% X €	ALL X
	Shpenzime Aparatesh (2)		43.6% X €	ALL X
	Shpenzime Transporti & Siguracion Magazine (3)		1.1% X €	ALL X
	Shpenzime Doganore + magazinash 6 dërgesa (4)		0.2% X €	ALL X

Shpenzime Agjent Servisi & knoë-hoë (5)		1.8% X C€	1.8% X ALL
Shpenzime Telefoni (6)		0.0% X €	0.0% X ALL
	Shpenzime Karburanti Administrative	0.1% X €	0.1% X ALL
	Shpenzime Administrative	0.4% X €	0.4% X ALL
	Shpenzime Qeraje + shpenzime zyre kancelari + shpenzime pastrimii + tjera	0.5% X €	0.5% X ALL
Shpenzime regjistrim produktesh AKBPM (S)		0.2 % X €	0.2% X ALL
Total shpenzime per Grifols Imunohematologji		100% X €	100% X ALL
Vlera e ofertuar dhe perqindja e fitimit per Pegasus shpk		17.0% X €	17.0% X ALL

Sic vihet re, nga analiza e detajuar e kostos, jo vetem qe ne arrijme të permbushim furnizimet e kerkuara brenda nivelit te kostove te perlllogaritura, por edhe rezulton nje norme fitimi prej 17 %.

f) Zgjidhjet teknike te perzgjedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve ose sherbimeve ose per kryerjen e punes;

Ne oferten e dorezuar nga shoqeriaa jone ne SPE per kete tender ne daten 20.05.2022, mund te verehet lehtesisht se ne permbushje te pikes 3 te Pikes 2.3 "Kapaciteti teknik", te Shtojces 7 te Dokumentave te Tenderit, ne kemi paraqitur dokurnentacionin qe verteton lidhjen direkte te shoqerise sone me prodhuesin Grifols.

Nga pikepamja e logjikes dhe objektive te biznesit, per shoqerine Pegasus. sh.p.k., kjo procedure ka nje rendesi shume te madhe. Duhet mbajtur parasysh, se QKTGJ, eshte klienti me i madh ne sektorin publik shqiptar per kete grup produktesh.

Duke qene distributor i vetem per Shqiperine qe nga viti 2016, i shoqerise Grifols (nga prodhuesit kryesore te testeve per imunohematologji, NAT testing sikurse dhe prodhuesi me i madh boteror i IVIG, albumin, Factor VIII dhe produkteve te tjera te plazmes), me ne fund, na u dha mundesia te plotesojme kushtet dhe te konkurojme per grupin e produkteve te kesaj procedure.

Ne kontekstin e mesiperme, Pegasus. ne pergatitjen e kesaj oferte, ka pasur jo Vetem qellimin dhe objektivin e jashtezakonshem per te fituar, por edhe mbeshtetje maksimale nga shoqeria prodhuese Grifols, si me planifikimin nga pikepamja teknike e perzgjedhjes se produkteve, ashtu

edhe ne oferten financiare, duke qene edhe vete Grifols te interesuar, te shenojne hyrjen per here te pare ne sektorin publik shqiptar me kete kategori produktesh.

Shiko Prova 1 - Email i dates 17/05/2022, me oferten nga z. Franck Le Comet, perfaqesues i Grifols, Menaxher per Evropen Qendrore dhe Lindore, ku shprehet "E kuptoj qe eshte shume kritike qe te hyjme tani ne QKTGJ dhe ne jemi dakord ta mbeshtesim Pegasus me akoma me shume zbritje per Vitin 1, me qellim qe te jete edhe me konkures" dhe me tej referon ne cmimet e Kolones M ne tabelen bashkelidhur e-mailit me nje vlere totale te ofertes se reagenteve prej 110,810.70 € dhe nje nga pajisjet gjithashtu ofrohet falas.

Per me teper, Kompania Grifols S.A ka ofruar aparatura te gjenerates se fundit plotesisht te reja, te cilat kane nje garanci prej 15 muajsh nga momenti i njoftimit te dergimit te tyre, duke u angazhuar maksimalisht per kete projekt

Sa më sipër shohim një komunik midis përfaqesuesve të kompanise blerëse Pegasus shpk dhe kompanise shitëse Grifols.

Shiko Prova 9 - email i dates 30/07/2022 nga Z. Franck Le Comet.

c) origjinalitetin e furnizimeve te propozuara nga ofertuesi;

Artikujt e ofruar nga Shoqeria jone plotesoje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara nga ju ne dokumentat e tenderit, te gjitha standardet nderkombetare te cilesise dhe pa dyshim eshte i padiskutueshem origjinaliteti i produkteve te ofruara, edhe per shkak te marredhenies tashme te konsoliduar tonen me prodhuesin sic sqaruam me siper. Kjo provohet lehtesisht nga dokumentacioni i paraqitur nga ana jone ne SPE, ne permbushje te pikave 2, 3, dhe 5 te Pikes 2.3 "Kapaciteti teknik", te Shtojces 7 te Dokumentave te Tenderit.

cc) pajtueshinerine me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes;

Shoqeria jone ka qene dhe eshte ne vijimesi zbatuese korrekte e normave ligjore e nenligjore te punes, mbrojtjes sociale apo mjedisore. Ne deklarojme dhe paguajme realisht dhe rregullisht punonjesit tane, si dhe sigurojme ne vijimesi kushtet e punes qe kerkohen nga legjislacioni ne fuqi. Kjo provohet lehtesisht nga fakti qe organet tatimore ne vijimesi konfirmojne shlyerjen e rregullt te detyrimeve tatimore dhe ato te sigurimeve shoqerore e shendetesore per stafin tone.

Gjithashtu, shoqeria respekton me perpikmeri dhe miremban ne menyre konstante te gjitha standardet e cilesise te aplikueshme ne fushen tone te aktivitetit, standarte pa te cilat do te ishte e pamundur te kishim marredheniet e distribucionit, aq me teper si distributor i vetem i drejtperdrejte, sic treguam me siper.

Duke shpresuar qe sqarimet e mesiperme se bashku me provat e paraqitura nga ana jone jane ezauruese, mbetemi ne pritje te vleresimit perfundimtar te ofertes sone."

Bashkëlidhur shkresës së mësipërme operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, ka dorëzuar gjithashtu: Email nga kompania Grifols për ofrimin e cmimeve favorizuese për vitin e parë për operatorin ekonomik “Pegasus” SHPK, për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Bashkëlidhur është paraqitur tabela me kostot e produkteve të ofruar nga Kompania Grifols. Gjithashtu, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK bashkëlidhur infomacionit të mësipërm ka dorëzuar Fatura për të llogaritur kosto transporti, Dokumentacion për punonjës të A.B, Listepagesa prill 2022, Fatura shpenzime telefonike, Garancia nga kompania Grifols, për 15 muaj të cdo aparati, por nuk ka kryer asnjë pagesë për produkte që do të blej ose nuk ka asnjë parakontratë preferenciale për procedurën objekt prokurimi.

III.10.7. Sa më sipër, gjykojmë se, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK në rastin konkret është në kushtet e premtimit, pra po zhvillojnë lirisht negociatën, pasi kompania Kompania Grifols i ka premtuar cmime dhe artikujt nepermjet komunikimit me email. Email nuk ka forcë të kontratës por është mjet informues dhe komunikues, bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë nënë 690 **“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët”**. Në kushtet aktuale nuk jemi në një marrëdhënie juridike sic parashikohet nga nënë 659 **“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”**, pra ofertuesi mund të propozojë dhe të premtojë por pa kryer aktin e shitjes së produkteve Subjektit “Pegasus” SHPK, i cili ka shprehur interes në procedurën e prokurimit në fjalë.

Gjithashtu nga verifikimi i listës së cmimeve për njësi të prodhuesit si dhe ofertës teknike të dorëzuar nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK nga ku rezultojnë se për një artikull në ofertën teknike propozime të perbehen nga më shumë se 1 nënartikull. Në rast se do të referohej cmimeve për njësi të prodhuesit si dhe artikujve të deklaruar në ofertën teknike të operatorit ekonomik rezultojnë nga një vëprim i thjeshtë matematikor, cmim * (her) artikujt (një artikull perbehet nga disa artikuj) e deklaruar në ofertën teknike rezultojnë se shuma totale e ofertës së prodhuesit është më e lartë se oferta e ofertuar nga operatori ekonomik në procedurën e prokurimit me objekt ankimi.

Në bazë të nënë 93 të LPP, përlllogaritja me anë të formulës me tre operator, që oferta e Pegasus” SHPK 30.936.080 lekë pa tvsh do të quhej e rregullt duhet të ishte minimalisht 38.152.272 lekë pa tvsh. Pra kjo ulje mund të çojë në mos realizim në kohë të objekt prokurimit duke lënë zbuluar shërbimin e autoritetit kontaktor i cili në rastin konkret lidhet drejt për drejt me jetën e qytetarëve.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik Laser Med shpk ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK qëndrojnë.

Si rrjedhojë e arsytimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të nënëve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 **“Për Prokurimin Publik”**, nënë 34, 46 të Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, gjykoj:

- 1- Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Lasermed” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-25594-04-19-2022, me objekt: Loti 1 “Karta, reagentë dhe aksesore të tjerë për Laboratorin Imuno-Hematologjisë ne QKTGJ dhe Bankat e gjakut në Tirane perfshire venien e pajisjeve ne perdorim”, me fond limit 59.233.237 lekë pa Tvsh, zhvilluar me datë 20.05.2022 nga autoriteti kontraktor Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut Tiranë.
- 2- Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
- 3- Ti propozojë Agjencise se Prokurimit Publik nisjen e hetimeve administrative sipas konstatimeve te mesiperme.
- 4- Ti propozojë Rrjetit të Koordinatorëve Anti-Korrupsion nisjen e hetimeve administrative sipas konstatimeve te mesiperme.

Anëtar

Kreshnik Ternova